



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0021659-1/25dt. 28.04.2025

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 39-të e rregullt e Kuvendit të Komunës

Koha: 28.04.2025 ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Nazmiye Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Hamdi Hasani, Egzon Hamza, Lavdim Zeneli, Nafiye Rexha, Mentor Vinarci, Faruk Mujka, Naser Muja, Kushtrim Zeneli, Ekrem Sadiku, Armend Begu, Hysen Muzliukaj, Jeton Zeneli, Erseka Barani, Xhevrije Bahtiri Ademi, Xhyljeta Imeri, Flutura Beka Kamberaj, Sevdaim Uka, Muhamed Hoti, Oltion Ahmeti, Ardita Aliu, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Vesel Neziri.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza

Nënkryetari i Komunës Z. Arian Tahiri

Drejtorët e Drejtorive

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Munguan: Shkurta Shosholli Musa dhe Elidiana Budini Haziri.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit Znj. Vesa Broja, e cila fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja e Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës kam thirrur mbledhjen e 39-të të Kuvendit të Komunës me rëndin e ditës të paraparë me thirrje. Po ashtu, ditën e premte e keni pranuar një email me material shtesë i cili sot do të propozohet si pikë shtesë në mbledhjen e kuvendit e i cili është Bartja e të hyrave të mbetura të vitit 2024 dhe viteve paraprake në vitin 2025, po ashtu si material shtesë e keni para vetës edhe disa dorëheqje të anëtarëve prej Komisioneve, të cilat do të propozohen që të futen si pika në rend të ditës sot, pra të bëhet zëvendësimi i anëtarëve, propozimi i parë pas dorëheqjes është zëvendësimi i anëtarit në Komisionin e Aksionarëve të KRU "Uniteti". E dyta, dy zëvendësime të anëtarëve të Komisionit të ankesave në përzgjedhjen e bordeve të drejtorëve në ndërmarrjet publike dhe e treta është zëvendësimi një anëtar në Komisionin për përzgjedhje të drejtorëve dhe zëvendësdrjtorëve në Institucionet Edukativo Arsimore dhe aftësuese, kështu që nëse ka dikush diçka për rend dite, po e hapi diskutimin.

Armend Begu: Në seancën e kaluar jeni zotuar se do ta sjellni si pikë të rendit të ditës trajtimin e çështjes për qenët endacak. Arsyeja pse nuk po e shihni këtë çështje si prioritet nuk po ju kuptoj. Pra, nuk kemi asnjë raport për shpenzimin e mjeteve, përkatësisht 320.000 €, të cilat janë ndarë, dhe ne nuk kemi marrë ende asnjëherë një raport që të dimë se si janë shpenzuar ato. Fjala është për vitin 2023. Ne kemi kërkuar që në këtë seancë të kemi atë raport, me mundësi që të diskutohet në këtë

seancë, pasi bëhet fjalë për një situatë urgjente. Ndërkohë, ju nuk e keni futur fare në rendin e ditës si pikë dhe nuk na keni sjellë asnjë material, për të cilin edhe jeni zotuar.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Buxhetin e kemi miratuar bashkë, një prej pozicioneve të mallrat dhe shërbimet është një shumë e ndarë për trajtimin e qenve endacak, procedurat janë në zhvillim dhe presim pas përfundimit të procedurave që ta kemi kontratën e re. Trajtimi i kësaj çështjeje, edhe kjo çështje është urgjencë dhe është domosdoshmëri edhe jo vetë në nivel të Komunës së Mitrovicës edhe ky problem nuk ka me mund me u zgjidh edhe me u adresua në mënyrën e duhur nëse nuk adresohet në gjithë Kosovën në të njëjtën kohë, për shkak se ti e bëni zgjidhje për një periudhë të caktuar kohore, ndërsa në komunat në fqinjësi nuk ndodh trajtimi, problemit njëjtë, prapëseprapë gjendja nuk ka me u krye krejtësisht. Sa i përket mjeteve financiare, të planifikuara janë të ndara me buxhet. Sa i përket raportimit Raporti vjetor financiar vjen në asamblë edhe i njëjti diskutohet edhe debatohet këtu në Kuvend, Nëse doni informata më specifike, duhet me qenë edhe ti më specifik çka po kërkon, cilat informata Nëse doni detajshëm për çfarë janë shpenzua, mundesh me pas qasje në gjitha faturat të cilat janë paguar, doni me i pa të gjitha pozicionet për çka janë trajtua. Prandaj ë mendoj që Nuk mundem me thonë që s'ka interesim, sepse interesim ka, sepse është urgjencë, është domosdoshmëri, kanë pësuar njerëzit, po pësojnë, i kanë sulmua edhe fëmijët të vegjël, Kontrata është në procedurë të hapur e fiton, aq e fiton edhe ai kush i plotëson kushtet. Prandaj mendoj që këto janë informata të cilat janë diskutua në Kuvend janë publike, nëse keni nevojë për të dhëna shtesë specifike, të lutna drejtoja me shkrim drejtorisë përkatëse, kompetente unë ju siguroj dhe ju garantoj që në përputhje me Ligjin kemi me ju informua detajisht për çdo cent të shpenzuar për këtë çështje z. Begu, nëse ki nevojë për çfarëdo informate shtesë edhe s'kanë qenë të mjaftueshme informatat që janë paraqitë në raportin vjetor financiar për vitin 2024, jemi të gatshëm edhe kemi obligim dhe do t'i qëndrojmë mbrapa detajshëm çdo faturë, e cila është pagu dhe për çfarë është faturuar.

Armend Begu: Unë prapë kërkoj që kjo pikë të futet si pikë e rendit të ditës, sepse besoj që ka kohë dhe është e domosdoshme të trajtohet. Sa i përket kësaj, duhet njëkohësisht, në të gjitha anët, të bëhet dhe të trajtohen edhe në qytetet e tjera. Unë mendoj se nuk ka nevojë të na bazoheni në qytete të tjera, sepse ne kemi probleme këtu. Unë mendoj se duhet të zhvillohet projekti për të kompensuar ata që janë kafshuar nga qenët endacakë, sepse ata, nëse çojnë e bëjnë padë, për shembull, nesër, Komunën nëse e padisin, ata do ta fitojnë gjyqin, do të fitojnë, dhe kur të fitojnë, shuma do të jetë më e madhe se sa për trajtimin e qenve.

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Po besoj që, përderisa nuk kam pranuar materialin për të cilin duhet të diskutojmë dhe të vendosim në rend të ditës d.m.th. as sot nuk mundemi pa material që ta fusim në rend dite, pra të gjitha materialet që i kam pranuar i kam futur në rend dite. E dyta, mos të personalizojmë; të thuhet 'ai po do', 'ai nuk po do'. Jemi dakorduar në seancën e kaluar që kjo është një çështje që na prek të gjithëve, dhe po besoj që është më mirë z. Begu ta përfundojmë diskutimin.

Armend Begu: Mos i jepni karakter politik, se ky është problem i të gjithëve dhe më intereson se pse nuk është si pikë sot në rend të ditës.

Xhevrije Bahtiri Ademi: Znj. Kryesuese, mund të më sqaroni pse që nga katër vitet e kaluara nuk është formuar komisioni për emërtimin e rrugëve? Po ashtu shumë palë, po presin këtë çështje. nuk e di pse, nuk po ndodh kjo.

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Sa i përket kësaj çështjeje, e di që e kemi diskutuar një herë në Kuvend dhe më është transmetuar që duhet formuar një komision, të cilin duhet ta formojë ekzekutivi, në këtë rast Drejtoria e Urbanizmit. Nëse duhet formuar nga Drejtoria e Urbanizmit, sot bashkërisht po kërkojmë nga drejtoria që ta formojë komisionin, pasi që është një nevojë e domosdoshme. Përndryshe, nëse është komision që duhet formuar nga Kuvendi ose diçka tjetër, mund ta formojmë pa problem.

Edison Tërnavaj: Faleminderit shumë, I nderuar Kryetar! E nderuar Kryesues, të nderuar asamblistë dhe ju kolegë drejtorë. Po, çështja e tillë është që dy vjet Drejtoria e Urbanizmit ballafaqohet me Agjencinë Kadastrale, e cila nuk na jep asnjë opinion ligjor lidhur me formimin e Komisionit për ankesa, edhe pse ne e kemi formuar një komision. Ata janë thirrur dhe kanë thënë që duhet të kalojnë dhjetë vjet nga periudha e emërtimeve të rrugëve, dhe për të drejtën e shfrytëzimit të emrave, ata kanë thënë se i keni vetëm listën ekzistuese, ku janë emrat e martirëve dhe dëshmorëve të kombit. Mirëpo, në komuna të tjera, kemi marrë vendime, se komuna e Gjakovës, e cila ka marrë vendim përmes Kuvendit për të formuar një komision, mirëpo Agjencia Kadastrale e ka shpallur atë vendim e ka shpall të jashtëligjshëm. Ne jemi prapë në komunikim me Agjencinë Kadastrale, për të gjetur një mënyrë juridike se si të formojmë këtë komision, përderisa ata nuk na japin asnjë informacion ligjor se si duhet të trajtojmë këtë çështje. Po flasim për këtë komision që më shumë se dy vjet e merremi me të dhe kemi pasur problematika. Është e paqartë se asnjë komunë nuk ka marrë opinion ligjor nga Agjencia Kadastrale për formimin e komisioneve, por disa komuna, pa informacion ligjor ose pa opinion ligjor nga Agjencia Kadastrale, kanë marrë vendime përmes Kuvendit. Megjithatë, ata kanë thënë se këto vendime janë të jashtëligjshme. Kështu që, mbetet të bëjmë përsëri një komunikim, përsëri të kërkojmë një zgjidhje dhe, në fund, një takim me Agjencinë Kadastrale për të marrë një kahje lidhur me këtë problematikë, e cila është shumë e madhe për qytetin e Mitrovicës.

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Atëherë propozojmë që të shtohet intensiteti i komunikimit, në mënyrë që të marrim një përgjigje ndoshta më të shpejtë dhe ndoshta një përgjigje përfundimtare se si duhet të formohet një komision i tillë, si dhe të na jepet një zgjidhje për problematikën që e kemi shfaqur edhe në disa seanca më herët. Kjo është e vërtetë. Atëherë, a ka dikush tjetër për rendin e ditës? Nëse jo, atëherë po vazhdojmë me propozimet e pikave që i përmenda më herët. Duhet t'i hedhim në votim një nga një, për të plotësuar rendin e ditës. Kështu që rendin e ditës po vazhdoj me plotësuar pas pikës gjashtë, pas planit e para raporteve.

Kush është që si pikë e 7 (shtatë) e rendit të ditës të futet Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara të vitit 2024 dhe viteve paraprake në vitin 2025

Rezultati i votimit: 32 - për, 0 - kundër dhe 0 - abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Propozimin.

Kush është që si pikë e 8 (tetë) e rendit të ditës të futet Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Aksionareve KRM "Uniteti".

Rezultati i votimit: 32- për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Propozimin.

Kush është që si pikë e 9 (nëntë) e rendit të ditës të futet Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordeve të Drejtorëve në Ndërmarrjet Publike.

Rezultati i votimit: 32 - për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Propozimin.

Kush është që si pikë e 10 (dhjetë) e rendit të ditës të futet Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit tjetër të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordeve të Drejtorëve në Ndërmarrjet Publike.

Rezultati i votimit: 32 - për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Propozimin.

Kush është që si pikë e 11 (njëmbëdhjetë) e rendit të ditës të futet Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të ri të Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve, zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsim.

Rezultati i votimit: 32 - për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Propozimin.

Faruk Mujka: Propozimin e z. Begu nuk e hedhët në votim.

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Propozimin e z. Begu mendova që nuk është korrekte me hedh në votim kur nuk kemi material. A pajtoheni z. Begu që pa material të fusim si pikë të rendit të ditës kërkesën tuaj.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Jo z. Begu, kërkoj falje, po sinqerisht kërkesa juaj duhet me qenë pak më specifike. A po e do kontratën, a po e doni shumën totale, a po doni pagesat individuale, apo po dëshiron me shkua dhe me i pa dosjet e secilit qen që u trajtua dhe fotografitë kur është marrë dhe kur është lëshu? Pra duhet me qenë kërkesa specifike çka mundemi me sjellë, pra të lutem specifiko se çka po kërkon dhe ne do ti sjellim, pra bëje një kërkesë apo me email, formën zgjedhe ti por të lutem specifiko se për çka je i interesuar që të të sillët.

Armend Begu: Po kryetar, nëse më lejoni, në fillim të mandatit unë e kam bërë një kërkesë të tillë që mu trajtua kjo temë si pikë e rendit të ditës, në fillim keni thënë që jena duke pritë prej ministrisë, për shkak të legjislacionit, rregulloreve vendimeve, urdhëresave administrative, kemi pengesa edhe ne kemi pasë mirëkuptim. Mirëpo, kjo situata është shumë e komplikuar në terren, Unë mund me kërku çka të duash, ose asgjë, por kur dalim në teren, situata është e rrezikshme. Unë kam mendu që do ti sjellni në këtë seancë sepse jeni dakorduar në seancën e kaluar.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Jemi ndër komunat e pakta që e kemi trajtuar këtë çështje edhe kemi ndarë mjete të konsiderueshme për këtë qëllim, jemi duke e trajtuar. Ju lutem specifiko cilat janë kërkesat tua, cilat informata ke nevojë ti kesh, nëse doni me i pa si janë harxhuar mjetet dhe pse janë harxhuar mjetet ne jemi të obliguar t'ju informojmë, t'i ofrojmë të gjitha detajet, çdo detaj, nëse doni mi pa dosjet, numrin, gjithçka, po të lutem veç mos flisni në mënyrë të përgjithshme si temë dhe në fund pa një konkluzion, një konkluzion i përgjithshëm që të gjithë e dinë. Pajtohem që kjo çështje është serioze dhe duhet ta trajtojmë.

Armend Begu: Unë kërkoj që çdo gjë të vijë me shkrim, për shkak se këtu, me fjalë, nuk po kryhen punët. Po harrohen çështje, po harrohen diskutimet, dhe problematika është e njëjtë. Ju më thoni që e kemi trajtuar këtë, por besoj se është dokumentacioni që kam parë, dhe aty është kontrata. Efekti është zero, nuk ka kurrfarë ndryshimi në terren, prandaj dua të di se çfarë mund të bëni për të përmirësuar situatën në terren. Ka disa raste që i kanë sulmuar qytetarët dhe nëse ata do ta paditin komunën atëherë ata dihet që do ta fitojnë rastin.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Jo z. Begu, nuk është efekti zero. Nëse u desh me u vaksinua ata qen, ata janë vaksinua. Nëse ti po thua, u deshtë me i vra e me i zhdukë, nuk guxon se ata janë në qytet. Pra ai që u vaksinua, kurrfarë garancie nuk ka, që s'të kafshon.

Xhevrije Bahtiri Ademi: Kryetar më vjen keq po nuk duhet kështu të reagosh se nuk thuhet ashtu me thënë me i vra, kur nëpër komunat tjera i kanë rregullua strehimoret për qenët.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Në cilin qytet dhe ku në cilin vend apo pjesë.

Xhevrije Bahtiri Ademi: Vushtrria e ka bërë, jam shumë e sigurt por në cilin vend nuk e di. Nuk jam përgjigjëse për Vushtrrinë.

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Atëherë u dakordua edhe për propozimin në fjalë edhe po vazhdojmë me miratim të rendit të ditës, me 14 pika të rendit të ditës, si në vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

2. Propozim vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut (HZK) 2024-2032
3. Propozim vendim për dhënicën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova
4. Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare
5. Kërkesa e DKA-së për subvencionim të Monografisë "Nxënësit e vrarë në Mitrovicë gjatë luftës së fundit"
6. Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara të vitit 2024 dhe viteve paraprahe në vitin 2025
7. Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025
8. Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara të vitit 2024 dhe viteve paraprahe në vitin 2025
9. Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Aksionareve KRM Uniteti
10. Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të në procedurën e përzgjedhjes së Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrje Publike
11. Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të në procedurën e përzgjedhjes së Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrje Publike
12. Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të ri të Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve, zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsim
13. Raport i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024
14. Raport financiar për periudhën janar-mars 2025
15. Pyetje dhe përgjigje

Rezultati i votimit: 32 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Rendin e ditës.

Pika 1

Kryesuesja e Kuvendit hapi diskutimin për Procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Rezultati i votimit: 32 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimitisht.

Pika 2

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Po vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: Propozim-vendim për miratimin e Hartës zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032. Fillimisht fjalën po ia kaloj Kryetarit mandej vazhdojmë me diskutime.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Faleminderit, Kryesuese! Të nderuar anëtarë të Asamblesë, është pikë tepër e rëndësishme kjo që diskutohet sot. Ka qenë një procedurë bukur e gjatë deri me u sjellë këtu në Kuvend për diskutim. Unë e kam procedua si pikë të rendit të ditës, përmes sekretarisë së Kuvendit në përputhje edhe me përgjegjësitë e mia si Kryetar i Komunës. Po e kam procedua vetëm atëherë kur jemi siguria që janë plotësuar kushtet ligjore që e njëjta të trajtohet, të diskutohet në Asamblenë Komunale. Këtë ma dëshmon edhe vendimi i ministrisë përkatëse të linjës, e cila ka vendim që konstaton se ky dokument i rëndësishëm për Mitrovicën, për qytetin e Mitrovicës, i plotëson kushtet ligjore që me u procedua në Asamblenë Komunale. Për më tepër, kam kërkuar me u plotësua edhe formulari që konstaton, konfirmon ligjshmërinë e këtij dokumenti. Kemi ftua edhe kompaninë e cila ka qenë e kontraktuar për këtë proces, është hera e parë që i kemi ftua të prezantojnë edhe në Komitetin për Politikë e Financa, ku të gjitha subjektet politike sipas formulës i kanë përfaqësuesit e vet, ku kanë pas mundësi me bë pyetje edhe me lyp sqarimet e nevojshme. Edhe unë i kam bë pyetjet e mia edhe kam pas nevojë për sqarimet e nevojshme. Sot jemi këtu, edhe unë ju lus

juve që, normalisht edhe me diskutua, edhe në fund secili prej jush me votua sipas bindjeve të juve profesionale. Çka jam i sigurt në këtë punë, edhe sipas vlerësimeve të juaja që nuk i ndaj me parti politike këtë çështje. Unë e kuptoj një periudhë të caktuar kohore mundem me kanë një parti politike me më shumë numra, në periudhën e ardhshme një parti tjetër me ndërrua këto situata, por jam i bindur që pa dallim politik, të gjithë anëtarët e Asamblesë e duan qytetin e Mitrovicës, e duan qytetin të zhvilluar, e mbrojnë interesin e Mitrovicës dhe e japin kontributin e vet në përputhje edhe me njohuritë e tyre profesionale edhe me bindjet e tyre. Unë asnjë anëtar të Asamblesë, prej asnjë grupi parlamentar që është i përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës, në asnjë mënyrë nuk e bëj, se kam bërë as të kaluarën, as në këtë rast, asnjë lloj ndikimi. Është në përgjegjësinë e juve me votua sipas bindjeve të juaja, e vlerësoni që është dokument mirë i përgatitur që është ligjërisht po e potencojë, si bazë është përdorë vendimi i ministrisë përkatëse të linjës, konfirmimi i ligjshmërisë. Tash, është një pjesë e bukur e qytetit që pritet me u urbanizua dhe me u shtrirë ndërtimi i lartë. Kjo trajton krejt Komunën e Mitrovicës, unë po e them atë që është pjesa e liqenit, ana e djathtë prej Suhodollit e tutje, bcsj që rritet dhe është vlerë e shtuar për qytetin e Mitrovicës. Përndryshe, të nderuar anëtarë të Asamblesë, pas diskutimeve ju votoni sipas gjykimit, sipas përgjegjësisë dhe sipas vlerësimit tuaj. Duke ju falënderua shumë për mirëkuptimin, unë kaq kisha me ju thënë, pjesa tjetër është në diskrecion të juve. Unë e vlerësoj çfarëdo vendimi, çfarëdo vote që jepni ju anëtarët e Asamblesë. Faleminderit shumë!

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Faleminderit shumë, Kryetar! Drejtor, a po shkojmë fillimisht me një përshkrim të shkurt prej juve, e mandej po vazhdojmë me diskutime.

Edison Tërnavë: Faleminderit, Kryesuese! Të nderuar përfaqësues të partive politike, në pika të shkurtra dua me i shpreh fokusin në shtatë pikat ku fokusohet Harta Zonale dhe rëndësia e saj. Rëndësia e hartës zonale komunale është shumë e madhe në administrimin dhe zhvillimin e territorit të një komune.

Në pikën e parë është planifikimi i qëndrueshëm, domethënë Harta Zonale ndihmon në organizimin racional të territorit, duke përcaktuar se cilat zonat janë të destinuara për banim, industri, bujqësi, shërbime publike, hapësirë të gjelbër e tjerë, kjo domethënë parandalon zhvillimin e pakontrolluar dhe kaotik i cili faktikisht është duke ndodhur.

Pika dy: Zhvillimin ekonomik, duke përcaktuar zonat industriale, tregtare dhe turistike. Harta krijon kushte më të mira për investime dhe rritje ekonomike në nivel lokal.

Pika tre: Mbrojtja e mjedisit, me ndarjen e qartë të zonave natyrore dhe parashikimin e hapësirave të mbrojtura, Harta Zonale ndihmon në ruajtjen e diversitetit dhe në minimizimin e ndikimit negativ në mjedis.

Pika katër e fokusit të hartës zonale: është siguri i shërbimeve publike. Harta orienton zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme si rrugët, ujësjellësi, kanalizimet, shkollat, qendrat shëndetësore e tjerë.

Pika pesë është transparencë dhe siguri juridike, ajo ofron një kuadër të qartë ligjor për ndërtimet dhe investimet, duke shmangur konflikte dhe duke siguruar transparencën për qytetarët dhe investitorët.

Pika gjashtë: menaxhimi i rrezikut. Në hartë identifikohen zonat e rrezikshme nga përmblytjet, rrëshqitjet e dheut apo fatkeqësitë e tjera natyrore duke ndihmuar në planifikimin për mbrojtjen civile dhe minimizimin e rreziqeve, dhe

Pika e shtatë është përmirësimi i cilësisë së jetesës, duke siguruar zhvillim të balancuar dhe shërbime të përshtatshme. Harta Zonale kontribuon në rritjen e standardit të jetesës së qytetarëve. Në thelb, domethënë Harta Zonale komunale është një mjet strategjik për zhvillim të qëndrueshëm, të drejtë dhe të balancuar të një territori.

Për procedurat dhe të gjitha tjerat se si kemi ecë këto vite me kompaninë e cila është marrë së bashku me komisionin, që ka qenë pjesë e hartimit të hartës zonale, në pika të shkurtra kisha ftuar

kompaninë e cila edhe sot është prezent me na japë një interpretim të shkurt se si ka rrjedhë gjithë kjo procedurë dhe çfarë është punuar në këtë hartë, domethënë tu i marrë parasysh të gjitha kërkesat edhe të qytetarëve edhe në ato të cilat ministria neve na i ka kthyer, të cilat janë pranua. Ja kisha kaluar fjalën te kompania d.m.th. e cila është prezent. Si përfundim, këto janë shtatë pikat të fokusit, që kanë qenë për hartimin e hartës zonale.

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja fjalën ia dha z. Armend Sokoli, përfaqësues in kompanisë hartuese.

Armend Sokoli: I nderuar Kryetar, Kryesuese, asamblistë, drejtorë dhe të gjithë ju të pranishëm. Unë jam Armend Sokoli, arkitekt urbanist nga kompania Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë "INSI", kompani e cila ka qenë e përfshirë në hartimin e këtij dokumenti shumë të rëndësishëm për komunën e Mitrovicës së Jugut. Gjatë diskutimit paraprak u tha që Harta Zonale si dokument i planifikimit hapësinor ka bazën e saj ligjore përveç bazës së saj profesionale. Sa i përket bazës së saj ligjore, ka Ligjin për planifikim hapësinor, mirëpo ka edhe të gjitha ligjet e Republikës së Kosovës të cilat kanë impakt në planifikim hapësinor, kjo duke filluar nga Ligji për ujërat, Ligji për tokën bujqësore, Ligji për pyjet e Kosovës dhe të gjitha ligjet e tjera, të cilat kanë një ndikim në planifikim hapësinor. Vlen të theksohet që me Ligjin e ri për planifikim hapësinor kërkohet edhe pjesëmarrja publike në procese të planifikimit hapësinor, ku gjatë hartimit të këtij dokumenti ne kemi pas disa diskutime publike me qytetarë, me grupin punues, me ekspertë të lirisë në komunën e Mitrovicës, takime me organizata joqeveritare që veprojnë në Komunë. Dhe, para se me i bë të gjitha këto komente, themi diskutime, Komuna ka bërë njoftimin e qytetarëve për këto diskutime publike, ku mund të them që kemi pas një pjesëmarrje të mjaftueshme apo të mirë në këto diskutime dhe të gjitha këto komente dhe sugjerime, propozime të qytetarëve janë trajtuar me grupin punues që ka pas komuna. Pra, të gjitha këto janë diskutua edhe në një workshop, që e kemi mbajtur me komisionin e komunës. Vlen të theksohet që Harta Zonale si dokument i planifikimit hapësinor, me Ligj të planifikimit hapësinor kërkohet që i gjithë territori i komunës të jetë i dixhitalizuar në sistemin gjeografik të informacionit, që është GJES, ku i gjithë territori, të gjitha edhe planet paraprake që kanë qenë, janë të digjitalizuar në sistem deri në nivel të parcelës që do të shohim në vazhdim. Gjithashtu, Harta Zonale komunale është hartuar bazuar në udhëzimin administrativ mbi normat teknike të planifikimit hapësinor. Udhëzim ky administrativ i cili përcakton të gjitha normativat duke u bazuar në numrin e popullsisë që ka komuna dhe duke u bazuar në aspektin profesional që është i përfshirë në këto norma. Pra, vlen të theksohet që këto norma të planifikimit hapësinor obligojnë që gjatë këtij hartimi të përdoren edhe direktiva evropiane, përveç direktivave vendore që i kemi siç është Inspire, Hajluks dhe HSRLC. Duke mos dashtë të marrim kohë, risi në legjislaturën e re është modeli i raportimit dhe monitorimit për zbatim ku komuna obligohet që pas aprovimit të këtij dokumenti të formojë një komision, i cili do të bëjë monitorimin dhe zbatimin e këtij dokumenti. Pra, sa është monitoruar, ku pas katër viteve, nëse është një përqindje e caktuar në Ligjin për planifikim hapësinor, nuk gjen zbatim ky dokument, mund ta merr dhe ta trajtoj revidimin dhe ri-hartimin e këtij dokumenti. Pra, do të thotë është si proces, i cili kërkon një monitorim se a jemi duke e zbatuar sipas kërkesave ligjore. Gjithashtu, ky dokument është i bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës, obligohet të bazohet edhe në hartën zonale të Kosovës, dokument ky i cili nuk e ka hartuar Ministria e Mjedisit për Planifikime Hapësinor dhe në planet hapësinore të veçanta. Vlen të theksohet që bazë ka edhe plani zhvillimor komunal, që është i hartuar dhe i aprovuar 2020-2028, pra ende në fuqi, ku të gjitha strategjitë, planifikimet dhe projektet që ka hartuar ky plan zhvillimor komunal, Harta Zonale merr dhe jep kushte dhe masa specifike se si duhet të zbatohen ato. Shembull konkret: nëse plani zhvillimor komunal ka paraparë një zonë banimi, Harta Zonale merr dhe jep kushtet ndërtimore duke u bazuar në normat teknike të planifikimi hapësinor, sa do të jetë etazhiteti, sa do të jetë koeficienti dhe këto norma teknike i bazojnë në numrin e popullsisë, pra sa është nevoja për ndërtim. Vlen të theksohet që ky dokument, si çdo dokument tjetër i planifikimit hapësinor, ka pjesën e tij tekstuale dhe pjesën

hartografike. Pjesa tekstuale paraqet të gjitha duke e bazuar në Udhëzimin Administrativ për hartimin, zbatimin dhe monitorimin për hartat zonale, akt nënligjor ky i Ligjit për planifikim hapësinor ku është prej pjesës së hyrjes, arsyetimit dhe janë kryesisht pra janë kushte zhvillimore të përgjithshme për të gjitha zonat. Kushte këto, vetë fjala që na thonë të përgjithshme vlen për të gjitha zonat dhe janë si për shembull ku secila parcelë duhet të ketë qasje në infrastrukturë publike, në infrastrukturë rrugore, në ujësjellës, në kanalizim, janë kushte më shumë gjenerale, mirëpo që i përfshinë të gjitha zonat. Gjithashtu specifik është lista e zonave, pra, i gjithë territori i Komunës së Mitrovicës është i ndarë në zona të veçanta, duke u bazuar në kategorinë që përmendëm direktivat evropiane Hilux, ku këtu janë të përcaktuara me ligj se si duhet të emërohen, shembull banim me një njësi, banim i përhershëm, banim i përkohshëm, toka bujqësore, prodhimi parësor, dytësor, të gjitha këto normative që janë të përmendura, këto janë pjesë e udhëzimit administrativ. Zonë quajmë dy apo më shumë parcela, të cilat kanë një shfrytëzim apo një destinim të ngjashëm, shembull dy apo më shumë parcela, të cilat janë të planifikuara për banim, për tokë bujqësore ose për zonë komerciale, ku këto në bazë të kërkesë ligjore, emërohen me një kod, shembull: zonë e banimit tre, katër, pesë dhe me këtë kod janë të paraqitura edhe pjesën hartografike që do t'i shohim. Pastaj më vonë janë edhe kushtet ndërtimore, ku në bazë të këtij kodi, shembull nëse e shohim ZB 3, ne i kemi të gjitha kushtet e paraqitura në pjesën tekstuale, të kushtet ndërtimore që na përcaktojnë çfarë etazhiteti, çfarë koeficienti, llojet e shfrytëzimeve. Është shumë e rëndësishme që me hartë zonale përcaktohen shfrytëzimet e lejuara ku saktë definohet se çka lejohet brenda zonës së banimit, janë shfrytëzimet e lejuara dytësore që janë shfrytëzime më shumë ndihmëse të zonës së banimit. Shembull ose brenda një zone lejohet të ketë një market, një kioskë, një çerdhe e cila i ndihmon, mirëpo janë shfrytëzime të lejuara të veçanta që jepen me kushte të veçanta prej komunës, janë shfrytëzime të lejuara të përkohshme, këto e kanë një periudhë, ku pas asaj periudhe mund të hiqen si tjera dhe shfrytëzimet e ndaluara, normal janë shfrytëzime të cilat i pengojnë zonës banimi dhe nuk lejohen të zhvillohen brenda asaj Zone, shembull një objekt industrial, apo diçka tjetër, që e pengon zonën e banimit për me u zhvillu. Gjithashtu, janë zonat mbishtresore. Kushtet zhvillimore për zonat mbishtresore janë specifike dhe shumë të rëndësishme. Shembull, nëse brenda një zonë e kemi planifikuar për banim, mirëpo në këtë zonë mund të ketë edhe karakter historik apo mund të ketë potencial për zonë arkeologjike nën të zona mbishtresore jep kushtet dhe masat se si duhet të ndërtohen ato duke mos e penguar. Apo shembull tjetër, mund të jetë një zonë e cila zhvillohet e planifikohet për banim, mirëpo aty mund të ketë rrezik për vërshime, dhe zona mbishtresore japin kushte, se cilat do të jenë masat mbrojtëse me u zhvillu banimi duke e pas parasysh edhe pjesën e rrezikut nga vërshimet edhe për këtë pjesë janë të paraqitura të gjitha kushtet. Tutje, pjesa tjetër është infrastruktura teknike, infrastruktura rrugore, publike dhe sociale. Infrastruktura teknike është pjesa e ujësjellësit, kanalizimit, kanalet e ujitjes, pra të gjitha këto zhvillime që janë të planifikuara, është shumë normale që duhet të përcjellën edhe me infrastrukturë teknike ujësjellës, duke analizua kapacitetet në bazë të zhvillimit që është planifiku dhe të cila do të jetë nevoja edhe për kanalizim. Ne kemi raste nëpër shumë qytete, kur një zonë ka qenë zonë banimi individual me shtëpi, ka kalua në zonë banimit kolektiv, mirëpo as ujësjellësi, as kanalizimi nuk janë harmonizuar me nevojën, se ne e dimë që normal nevoja është shumë e madhe për kanalizim, ujësjellës, infrastrukturë rrugore, zgjerimi i rrugëve e të tjera.. Pra, gjithashtu është infrastruktura rrugore përbrenda, pastaj infrastruktura publike dhe sociale është infrastrukturë që paraqet parqet, objektet shëndetësore, objektet shkollore. Pra, në bazë të zhvillimit që planifikohet në komunë, planifikohet edhe pjesa e infrastrukturës publike dhe sociale. Vlen të theksohet që Ligji për planifikim hapësinor me obligimin e komunave për me hartua hartën zonale, e ka parapa edhe arsyetimin për nevojën e hartimeve të planave rregulluese të hollësishme. Pra, aty ku komuna nuk ka mundësi me dhanë kushte ose ku nuk mundet me bë zgjidhje vetëm me hartë zonale, arsyetohet që është nevoja për hartim edhe planit rregullues më të detajuar edhe më të hollësishëm për të zgjidh këto probleme. E përmendëm edhe pjesën hartografike, ku janë këto harta, të cilat e thamë që është ndërlidhje me pjesën tekstuale.

Pra, nëse e shohim që është ndoshta edhe një ndër më të rëndësishme, është harta e shfrytëzimit të tokës ku të gjithë ato kushte, ato kode dhe ato zona ne i kemi të paraqitur edhe në pjesën hartografike. Pra, kushtet që i kemi në pjesën tekstuale, shembull: për ZB 7, ZB 5 apo krejt zonën e shërbimeve 2, lidhen me pjesën hartografike mirëpo e përmendëm edhe më herët digjitalizimin në 2 Programi GJIS, ku gjitha këto janë digjitale. Pra, e gjithë Harta Zonale komunale është e digjitalizuar deri në nivel të parcelës, dhe këto kushte ndërtimore mund t'i shohim direkt në pjesën hartografike dhe të digjitalizuar për secilën parcelë deri në nivel të parcelës dhe të shihen cilat janë kushtet brenda kësaj zone. Duke mos dashtë me ju marrë kohë më shumë ju kisha falënderua për vëmendjen dhe kjo është pjesa ndoshta në pika më të shkurtra të mundshme të prezantimit të një harte zonale, sepse po flasim për një dokument shumë voluminoz, i cili shkon deri në 300 faqe, si pjesë tekstuale. Kështuqë jam munduar me i paraqit pikat më të rëndësishme ose ndoshta më kryesore. Ju faleminderit!

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Faleminderit shumë! Atëherë, nëse jena dakord, po vazhdojmë me diskutime. E hap diskutimin.

Flutura Beka Kamberaj: Përshëndetje për të gjithë, i nderuar Kryetar, i nderuar Nënkyetar, e nderuar Kryesuese, të nderuar kolegë asamblistë, të nderuar drejtorë, të nderuar të pranishëm. Sot jemi para një vendimi tejet të rëndësishëm për të ardhmen urbane të qytetit tonë, miratimi i hartës zonale të qytetit të Mitrovicës. Si asambliste, dua të shpreh mbështetjen time të plotë për këtë dokument strategjik dhe të theksoj rëndësinë e tij në ndërtimin e një qyteti modern, të organizuar dhe funksional për të gjithë qytetarët tanë. Pasi që të gjitha procedurat ligjore dhe administrative që lidhen me këtë proces tashmë veç kanë përfunduar, janë mbajtur diskutimet publike, janë trajtuar ankesat dhe janë siguruar aprovimet e nevojshme nga ministria përkatëse, pra, sot jemi në pikën finale, ditën kur duhet të japim miratimin përfundimtar dhe të ecim përpara. Harta Zonale nuk është vetëm një dokument teknik, ajo është një bazë e domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të qytetit të Mitrovicës. Ajo siguron një planifikim të drejtë të hapësirës, parandalon ndërtimet e pakontrolluara dhe krijon kushte më të mira për investime, infrastrukturë dhe mirëqenie për banorët tanë. Përmes kësaj harte, ne duhet të vendosim rregulla të qarta për përdorimin e tokës, të krijojmë kushte për zhvillimin e zonave të reja të banimit dhe afarizmit, dhe t'i japim qytetit një drejtim të qartë urban. Kjo është edhe një mundësi për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për brezat që vijnë. Unë e përkrahi aprovimin e hartës zonale.

Nafije Rexha: Përshëndetje për gjithë! Përderisa e kemi para vetës një projekt shumë madhor për qytetin e Mitrovicës mendoj dhe shpresoj që të gjitha pikat pajtojnë plotësisht. Edhe më tepër parafolësi, që në mënyrë të detajuar, d.m.th. i preku pikat kyçe për cilat ndikojnë pozitivisht në dukjen e qytetit tonë, në urbanizimin e qytetit tonë, dhe i japin frymë qytetit. Kështu që, unë e përgëzoj drejtorin e drejtorisë së Urbanizmit për punën e bërë dhe shpresoj e besoj që ata që duan Mitrovicën ndryshe dhe që duan ta shohin një urbanizëm me stil evropian atëherë duhet t'a përkrahim dhe duhet të jemi pro këtij projekti madhor.

Faru Mujka: I nderuar Kryetar, Nënkyetar, Kryesuese, ekzekutiv, kolegë asamblistë, shoqëri civile e bashkëqytetarë të nderuar. Edhe ky propozim apo projekt, faktikisht është i vonuar apo dështuar sikur edhe shumica e projekteve, që janë tentuar të realizohen deri tani. Sikur ato rrugët "Ali Zeneli", "Lah niman", "Mbretëresha Teutë" Rruga e Shipolit, "Dëshmorët e Kombit" për të cilët është premtuar se do të kryhen për pesë-gjashtë muaj, por ja edhe pas katër vite, pothuajse janë aty ku kanë qenë edhe kur e keni marrë mandatin. Mos të flasim për projekte që nuk keni filluar fare, si: Shkolla e Muzikës, Muzeu i Qytetit, Shtëpia e Pleqve, impianti për trajtimin e ujërave të zeza, salla e edukatës fizike, shkolla Abdullah Shabani, renovimi i objektivit të sportit Fatime Gjaka, Lagjja Kolonia Anglez në Stantërg, shtëpia shurdhë-memecëve, qendra tregtare me parkim nëntokësor te Shtëpia e Mallrave, banesa për çiftet e reja me kosto të përballueshme, shtëpia për viktimat e dhunës në familje, transporti publik e shumë e shumë të tjera. Pajtohem që Harta Zonale është një dokument bazik, i cili është deshtë me qenë ndër të parat e këtij ekzekutivi por sigurisht ka një arsye për një

shtyrje kaq të madhe, e këtë më së miri e din ekzekutivi aktual. Propozimi që na ka ardhë, ka dy probleme shumë serioze teknike apo profesionale politike dhe juridike. Unë do të tentoj të flas vetëm për të parën. Fillimisht, ky propozim ka ardhur ekstremisht më shumë vonesë dhe atë më shumë për shkak të nevojës juridike se dëshirës për të qenë këtu sot. Vendimi për hartimin e hartës zonale, ashtu edhe siç po thonë disa hipokritë, që po shikojne me e shty agjendën përpara, është marrë më 20 Prill 2020 nga ekzekutivi i kaluar dhe është e dashur të përfundojë brenda tetëmbëdhjetë muaj dhe atëherë do të ishte në hap me PZHK-në 2020-2028. E dimë se ndërkohë janë mbajtur zgjedhjet lokale, dhe fatkeqësisht, kemi pasur ndërrim të ekzekutivit dhe komplet agjendës së përcaktuar më parë. Patjetër që ne jemi krenarë me punën që kemi bërë për të dy këto dokumente. Fillimisht, por edhe pas zgjedhjeve, janë mbajtur disa diskutime publike me qytetarë të qendrës dhe pastaj gjithçka u mbështjell me heshtje dhe mister. Me 06 Shkurt 2023, nga ministri Liburn Aliu është nënshkruar vendimi për pëlqim mjedisor, për raportin për vlerësim strategjik-mjedisor për hartën zonale të komunës Mitrovicës - Jugut 2023-2027. Te kjo hartë zonale keni shumë data dhe paqartësi. PZHK origjinale është valide për vitet 2020-2028. Është interesant në dokument nga Ministria thuhet se Komuna e Mitrovicës së Jugut gjatë hartimit të hartës zonale të komunës është bazuar në planin zhvillimor komunal 2023-2031. Pëlqimi mjedisor është dhënë për 2023-2027, ndërsa neve na jepet votim Harta Zonale 2024-2032. A bënë, fillimisht veç me ditë sakte, cilat vite i përfshin Harta Zonale aktuale, duke e shtjelluar edhe atë zbrazëtirën 2020-2025 ku PZHK nuk është përcjellë në pjesën integrale të saj apo derivatin e saj të Harta Zonale. Apo edhe sa do të vlejë kjo hartë pas vitit 2028, kur PZHK aktuale mos të jetë më valide? Një ditë, me një prononcim për një Tv dëgjova drejtorin, duke ia dhënë tre konstatime në lidhje me hartën zonale, për të cilat mendoj se kanë qenë pak të pasinqerta. Ai tha: Ministria na e ka kthye pesë herë propozimin tonë. Nëse e ka kthye, atëherë ka ndodhë për arsye se ka qenë kundërshtim me PZHK-në apo nuk i keni përmbushë kriteret e caktuara ose keni deshtë me përbirë pikat të cilat nuk e kanë pas vendi aty, por mbi të gjitha unë nuk kam parë dhe nuk kam ditë se është kthye ndonjëherë. Nëse ka ndodhur një gjë e tillë, kishte me qenë një me sjellë dëshminë e dërgesës dhe atë të refuzimit të ministrisë. Vendimi nga Ministria ka ardhë me 13.11.2024, por thatë ne nuk e kemi procedua për shkak të zgjedhjeve edhe kjo është plotësisht e saktë, sepse ligjërisht është maksimum 30 ditë pas kësaj date ju është dashur ta procedoni për miratim në Kuvendin Komunal. Ndërsa, ju nga frika se do t'i irritoni qytetarët dhe kjo do të ndikonte negativisht në imazhin e kandidatit për Kryeministër, zoti Bedri Hamza, në fushatën që pritet të zhvillohet, ju këtë propozim e keni mbajtur në sirtarë. Madje këtë nuk do ta sillnit as tani, po të mos ishte për shkak të kërkesave të shumta nga palët e interesuara dhe obligime ligjore. Pastaj thoni se edhe neve po na bëhet dëm, sepse nuk po mundemi me i inkasua të hyrat nga lejet ndërtimore dhe po bllokohet zhvillimi i komunës, kjo nuk qëndron fare, sepse e kemi ditur që plani që po prezantoni sot është i pafavorshëm për ndërtuesit dhe pronarët e ngastrave dhe keni dhënë me grushta leje ndërtimore të pabazuara, duke shpërfillur edhe planet aktuale rregullative për lagjet e caktuara, të cilat do të anuloheshin pikërisht ashtu siç i keni caktuar në vendim. Pra, vetëm kur të votohet kjo hartë zonale, atëherë anulohen ato plane rregullative që duhet me qenë hala aktuale deri sot. Pra, ato plane rregullative do të duhej të jenë akoma valide. Një shembull, si i keni anashkaluar plotësisht ato dhe keni bërë shkelje të rëndë, është Rruga "Vëllezërit Dragaj", ku koeficienti në njërin anë të rrugës ka qenë 1.1, ndërsa në krahun tjetër 2.1. Fatkeqësisht, të dy anët janë të mbushura me objekte me koeficient mbi katër. Njëjtë keni vepruar edhe në projektin e fundit, atë përballë Qerdhes së fëmijëve, e cila ka qenë e dedikuar për afarizëm ku keni dhënë leje ndërtimore që tejkalon etazhitetin e lejuar me çfarëdo dokumenti të Komunës së Mitrovicës. Me një fjalë, vonesa kaq e madhe me përpilime dhe sjellje në hartën zonale para neve, nuk ka si mos të kuptohet, po vetëm se një mënyrë që të bëni sa më shumë tejkalime të normativës ndërtimore dhe të krijoni favore të ndërsjella në operatorë ekonomikë. Në realitet, harta e re zonale do të duhej të sillte pak rend dhe ligj në këtë fushë, por fatkeqësisht edhe këtu jeni përkujdesur që të ketë favorizime, padrejtësi dhe kalkulime. Gjëja më e

mirë në këtë hartë është se është vënë një tavan me lartësinë e objekteve që duhet të hetohen. Edhe pse mua personalisht më shumë më ka brengosur më herët gabërimi horizontal i tokës duke minimizuar hapësira gjelbëruese, parkingjet dhe këndet e lojërave për fëmijë, sesa lartësia që do të duhet të ndërtohet një objekt. Dua të theksoj se sipas asaj që kam kuptuar unë, koeficienti maksimal në këtë hartë zonale do të jetë tre, e që është për 30% më i ulët se ai deri tani, e kjo kryesisht për shkak të zhvillimeve demografike të qytetit, në rend të parë për shkak të ndarjes së saj. Tani lindin disa probleme: e para krijohet pabarazia ndërmjet fqinjëve të parë, posaçërisht në qendër të qytetit, ku njëri deri tani ka ndërtuar me koeficientin 4.5 ndërsa ky tani me maksimum 3. Apo, figurativisht, nëse dikush më parë ka ndërtuar nga 10 kate, tani e tutje do të ndërton maksimum pesë, apo gjashtë, përdhese plus gjashtë kate. Në Planet Rregullative kanë qenë të përcaktuara qartë rrugët dhe infrastruktura tjetër përcjellëse, ndërsa këtu mbetet të rregullohet në rrugë e sipër që mund të sjellë deri te ndërtimi i pakontrolluar apo rebllokimi i dy lagjeve. Mbi të gjitha keni dy pika analogjike, të cilët i pengojnë shumicën e qytetarëve shpirtërisht. Bëhet fjalë për të dy anët e liqenit artificial, të cilat fillimisht janë projektuar për rekreacion dhe zhvillim të hotelarisë dhe turizmit të qytetit, është e pakontestueshme se të gjithë jemi të interesuar për ndërtim atje dhe popullim. Por, gjithsesi të kontrolluar dhe shkallëzuar, e cila nuk do të ngulfaste qytetarin dhe qytetin. Është krejtësisht e pakuptueshme që në 50 metra nga Liqeni të kemi objekte shtatë katesh. Jeni të vetëdijshëm se janë blerë shumë ngastra nga ana e Suhodollit, dhe atë me çmim të lartë, dhe tani pritet që ato investime të kthehen, por assesi në shpinë të qytetarëve, të funksionalitetit të qytetit, ka mundur të mendohet për një shkallëzim të ndërtimit, kur rendi i parë do të fillojë me objekte 2-3 kateshe, normal me çmime më të lartë për ata që kanë e pastaj të vazhdojmë me rritjen e lartësisë, por fatkeqësisht është shikuar vetëm një anë e medaljes. Storie pak më tjetër e kemi edhe në Lagjen Fidanishte ku nëpërmjet këtij ndërtimi të dendur, pos që shndërrohet bregu i liqenit, aty ka tendencë edhe të legjitimitit të pronave të blera në mënyrë të dyshimta, dhe që për momentin me sa di unë janë në proces gjyqësor. Anomalia kryesore e kësaj harte zonale është se ekzekutivi aktual sinqerisht nuk është marrë as minimalisht me të, siç thashë më lart, bazamenti i saj është shtruar në vitin 2020, të jetë në përputhshmëri me PZHK-në, ndërkohë ekzekutivi ka punuar pa konsultuar fare PZHK-në dhe këto ndryshime as që është marrë munda të përcillen në hartën zonale. Kështu, sipas Hartës Zonale QKMF-ja e re akoma duhet të ndërtohet tek Universiteti, ndërsa QMF-ja e re e ndërtuar në Iliridë, të shndërrohet në qerdhe. Nuk janë planifikuar as 6 qerdhet e premtuara nga Kryetari Hamza. Plani i mobilitetit, dokumenti ndoshta më kualitativ që kemi, nuk kemi gjetur fare zbatim. Në këtë hartë, fare nuk janë marrë parasysh as ndikimet ambientale dhe ligjet apo standardet e reja të efikasitetit të energjisë për ndërtimet e reja. Me tërë këto kundërshti njëra medoemos duhet të ndryshohet, PZHK-ja ose Harta Zonale, logjika thotë se Harta Zonale, pasi është derivat i PZHK-së dhe akoma nuk është i aprovuar. Unë e di se të gjithë ckziston droja e votimit të kësaj harte zonale për motive të ndryshme, kush donë le ta tregojë, kush nuk donë ta mbajë për vete.

Grupi i Asamblesë së Lëvizjes Vetëvendosjes nuk ka votë për këtë hartë, për arsye të cilat u cekën më lart, por edhe për ato të cilat do të ceken në vazhdim. E di se do të ketë tendencë të akuzohet Lëvizja për bllokim të qytetit e cjtje kundër qytetarëve, por ju asnjëherë nuk mund të largoheni nga përgjegjësia për vonesën e kësaj harte dhe keqpërdorimet që janë bërë në emër të hartës dhe në mungesë të së njëjtës. Ka edhe të tillë që preferojnë të mos votohet harta, në mënyrë që të vazhdojnë me leje pa limite, por po harroni se jeni duke shkelur me dy këmbët Planet Rregullative, që pezullohen tek pasi të votohet Harta Zonale. Normalisht që mendojmë se Komuna ka nevojë për Hartë Zonale, por për dokument origjinal që përfshin ndryshimet dhe nevojat në kohë reale dhe që është në përputhje të plotë me planin zhvillimor komunal dhe ndryshimet e bëra gjatë viteve. Nëse kryeni ndryshimet e duhura në përputhje me dokumentin bazë, me kënaqësi do ta votojmë Hartën. Sidoqoftë, zgjedhjet lokale janë afër. Andaj, nëse nuk keni qenë të zotët t'a hartoni këtë dokument për katër vite, atëherë më e mira e mirës është ta hartojë ai që e merr përgjegjësinë për Komunën për katër vitet e ardhshme.

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Ju faleminderit, z. Mujka! Veç për sqarim, kalimin e minutazhës së lejuar të diskutimit po e bëjmë me vetëdije, për shkak të rëndësisë që e ka pika.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Z.Mujka do të koncentrohem në këtë pjesën politike, se pate fjalimin e kombinuar politik, juridik e profesional. Pjesën profesionale mendoj që ma me kompetencë e flasin profesionistët e kësaj fushe edhe unë jam i prire me ju besua njerëzve profesional. Ndërsa në pjesën politike, i përmende disa projekte të vonuara, nuk po dua me lodhë Asamblenë, po unë po t'i përmendi ato punë të kryera.

E para, që kjo nuk i prek drejtpërdrejtë qytetarët e Komunës së Mitrovicës, mirëpo konsideroj që një prej punëve më të mëdha që ka ndodhë është konsolidimi financiar i Komunës së Mitrovicës. Me ç'rast ne si ekzekutivë kemi qenë të detyruar dhe jemi përballuar me pagesën, kam thënë më herët 6.000.000,00 €, mirëpo u kërkoj falje se janë mbi 12.000.000,00 € obligime të prapambetura, borxhe që i ka trashëguar ky ekzekutiv pa fajin e tyre, që një pjesë e madhe për hir të korrektësisë janë si rezultat i kontratave kolektive, por ka edhe obligime ndaj operatorëve ekonomik.

E dyta, rrugët që në Mitrovicë për 50-60 vjet, unë e vlerësoj edhe një rrugë që kryhet në periferinë më të madhe të Mitrovicës, por në qytet nuk i ka prek askush. Rrugën në Mbretëresha Teutë me komplet infrastrukturën nëntokësore, rrugën "Ali Zeneli" që ka qenë e planifikuar prej shumë dekadave, me shumë vështirësi, asnjë nuk e mohoi sepse një shtëpi në koftë shpronësuar, aty e vlerësoi, është kah përfundimi. Rruga "Lah Nimani", e njëjta gjë. Keni dhënë leje, por shumica e lejeve janë në kohën e juve, ju keni jap leje pa infrastrukturë, pa kanalizim, as ujësjellës, as rrugë. Keni këmbye prona në bazë të vendimeve për interes publik, që fare nuk kanë të bëjnë me ato rrugë. Nëse doni me pa, është ndërtua QKMF-ja e re që është ma e bukura në Kosovë edhe sot çdo ditë kanë mundësi me e shfrytëzua njerëzit. Është ndërtua QMF-ja e re në Iliridë, është ndërtu QMF-ja e re në Koshtovë, është ndërtu ambulancë apo qendër e mjekësisë familjare me Stantërg. Pastaj janë rinovua komplet objektet në Bare, Bajgorë, Rashan, Vllahi dhe Shipol. Ju thatë janë mbajtur zgjedhjet.

U fillu Harta Zonale në vitin 2020, shumë mirë. Ekzekutivi e ka parapa në 2020-ën që Mitrovica duhet me pas Hartë Zonale, shumë mirë e keni nis. Fatkeqësisht the, u bë ndërrimi i ekzekutivit, fatkeqësisht për ty, fatmirësisht për neve dhe për qytetin. I përmende gjashtë qerdhe, po krejt deklaratimet e mia, krejt planin tim zgjedhor e kam publik me premtimet e mia një për një, dhe në fund, kam me qenë krenar dhe kam me thënë: këto i kam premtu, këto i kam realizu. E shohim se çka kam realizua. Ato që nuk i kam realizuar, sigurisht kam me thënë më falni se gjatë rrugës ose s'kam ditë, ose s'kam mujt, ose ka pas pengesa e s'e kam realizu, po jam i bindur që kam me qenë prej kryetarëve që kam përmbush më së shumti premtimet edhe në arsim, edhe në shëndetësi, edhe në infrastrukturë, edhe sport edhe kulturë. Tutje, Çerdhja Gëzimi Ynë, unë fëmijët i kam pas aty, e di në çfarë gjendje ka qenë. Ndërsa shkoni sot dhe shikojeni. Çfarë gjendje është? Çerdhja në Shipol pritet, është procedurë me u plotësua stafi edhe me u lëshua. Çerdhja te Desi, a është e re, a e vjetër ajo është t'u ndërtua, shko shikojte sot! Tjetra, Çerdhja te shkolla e mesme teknike, fatkeqësisht, unë i jam shumë i mirënjohës, është investim edhe punë e përbashkët e nivelit lokal edhe qendror, komuna e ka dhënë tokën, ministria e ka dhënë financimin, operatori ekonomik i ka krye punët e vrazhda dhe aty e ka lënë. Janë edhe dy qer Çerdhe të reja, dhe u bënë katër ekzistuese. Edhe dy Çerdhe të tjera e kanë buxhetin, unë pres me u nisë në Kqiq edhe në Urë të Gjakut edhe Mitrovica po i bën gjashtë Çerdhe publike.

Sa i përket çështjeve tjera, dhënies së lejeve, gjithëcka tjetër, unë jam shumë i interesuar që gjithëcka të bëhet në mënyrë ligjore, profesionale edhe gjithëcka çka s'është ligjore gjithmonë them duhet me u zbatua Ligji. Kështu që në aspektin legal nuk ka askund ligj që e detyron ekzekutivin, nivel qendror apo lokal për me e procedua një pikë si rend ditës brenda tridhjetë ditëve. As Ligji, as Rregullorja e as Udhëzimi Administrativ. Besoj që e keni në dokument, unë me 25.03.2025 e kam marrë formularin e nënshkruar për konfirmimin juridik që kjo lëndë i plotëson kushtet ligjore për me u procedua në Kuvend. Me 23 Mars 2025 është pjesë e materialit të cilin e ka nënshkrua iniciuesi, në këtë rast

Drejtoria e Urbanizmit, të gjitha nivelet edhe Zyra Ligjore, sepse unë nuk procedoj në Kuvend dokumente të rëndësishme të tillë pa u sigurua që ligjërisht jemi në rregull. E sa i përket zgjedhjeve, kush e keni ndërmend nuk janë larg, bëhuni gati, fiton ai që i merr votat edhe ai qeverisë, edhe kushdo që qeverisë unë besoj që ka me qeverisë mirë edhe në dobi të qytetit të Mitrovicës. Nuk e kam atë siklet sot, sepse po flasim për Hartën Zonale. E kisha mirëprit kontributin e juve gjatë gjithë kohës të përgatitjes të hartave zonale, për shkak se edhe e di që ke edhe përvojën në të kaluarën si pjesë e institucioneve, po edhe në aspektin profesional kish me qenë e dobishme edhe e vlefshme. Këto janë në këtë nivel, unë ma herët e thashë, edhe unë i kam pas pyetjet e mia, jo në aspektin profesional të vijës ndërtimore e të tjera, se është çështje e inxhinierëve, po në aspektin e logjikës ekonomike të gjitha senet tjera i kam bo pyetjet e mia, prapçesaprap këtu e thashë që kushdo qysh do le të voton edhe këta asamblistët e koalicionit e të opozitës, unë jam në rregull. Për mua është në rregull. Ju e keni të drejtën e plotë me votu sipas bindjeve tuaja. Unë po them ma shumë profesionale po që don dikush edhe politike, është e drejta e tij/saj. Jam në rregull.

Faruk Mujka: Unë me ato rrugë nuk po du me u marrë se ti e di që edhe Rruga e Shipolit, edhe ajo Mbretëresha Teutë as nuk janë të pranuar, as nuk janë të paguara, se i ke pak më vonë, që do ta ketë me pagu nga mbartja e mjeteve. As Rruga Ali Zeneli, as Rruga Lah Nimani nuk janë gati. edhe aty u shtru asfalt në pronë private nuk janë shpronësuar tokat, u shtru Rruga, kanalizimi është përzi me ujërat atmosferik sa për informatë, po s'ka të bëjë me këtë Hartë Zonale. Harta Zonale i ka problemet e veta, sepse vjen pesë vjet pas planit zhvillimor komunal edhe nuk i ka të përfshimë ndryshimet që janë bërë ndërkohë. Domethënë, kjo Harta Zonale nuk korrespondon me Planin Zhvillimor Komunal. Nuk i përfshin nevojat aktuale dhe rrethanat aktuale pas pesë vjetëve të PZHK-së. Edhe një herë po të them, QKMF-ja e cila po mburresh me të, është që duhet me u kanë qatë te universiteti, hala në Hartë Zonale të shkruan që QMF-ja e Iliridës duhet me qenë çerdhe. Mos të themi atë që tash Harta Zonale i ka të vjetra pra veç tri vjet janë së bashku me PZHK-në. Në 2028 përfundon Plan Zhvillimor, faktikisht prej 2027-ës duhet me fillua me punua, ndërsa prej 2028 deri 2032 ku mbahet kjo, sepse kjo është derivat i PZHK-së. Edhe kryetar, ti ndoshta e ke marrë letrën prej drejtorit në muajin Mars. Por ti the, unë jam bazua se është e ligjshme prej Ministrisë të Ambientit, e ajo të ka ardhë me 13 nëntor. Pse nuk e ka procedua drejtori deri me 30 Mars, atë e dini ju të dytë.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: z. Mujka, unë nuk jam duke e punu, ky nuk është dokument personal i imi, unë e kam proceduar në Kuvend, ju e keni para vetes. I plotëson kushtet, e vlerësoni, e votoni, nuk i plotëson kushtet, jepni vërejtjet e juaja, jeni plotësisht të mirëkuptuar, votoni sipas bindjeve dhe gjykimit të juaj profesional. Kaq!

Kryesuesja e Kuvendit znj Vesa Broja: Faleminderit, kryetar! Po vazhdojmë, me diskutime.

Muhamet Hoti: Faleminderit, e nderuara Kryesuese! I nderuari kryetar, nënkryetar, ekzekutiv, juve kolegë. Edhe unë si jo-njohës i kësaj lamic të inxhinierisë edhe çështjes së urbanizimit, po jam njohës i atij drejtimit dhe profesionit tem dhe dua të flas shkurtimisht në ato që e shoh se çka është profit dhe çka nuk është profit kjo puna rreth Hartës Zonale. Në parim, Harta Zonale unë e mendoj se është një proces shumë i rëndësishëm, për shembull, për zhvillimin e qytetit, zhvillimin urban dhe planifikimin hapësinor në Kosovë, në veçanti për qytetin tonë. Mirëpo, duhet të lidhem aty ku e kam si brengë edhe ku e kam si amanet në cilësi të përfaqësuesit të qytetarëve më saktësisht të zonës urbane dhe zonës qendra. Do të lidhem direkt për çështjen e një koeficienti që është në zonën urbane. Nëse koeficientin e ndërtimit të hartës zonale i caktohet nga Drejtoria e Urbanizmit saktësisht nga komuna, niveli lokal, duke u bazu gjithmonë në përputhje me kornizat ligjore shtetërore, Ligjin për planifikim hapësinor dhe politikën zhvillimore, unë kërkoj që të bëhet një editim apo kam një vërejtje tek zona urbane, e cila më saktësisht me koeficientin maksimal është tre, të rritet në katër plus dhe këto i propozoj direkt drejtorisë për urbanizëm që të përgatisë një analizë të cilën t'i jap një rekomandim të detajuar për rritjen e koeficientit. Pse të bëhet rritja e koeficientit, nuk sheh hajr dhe nuk është profit vetëm i qytetarëve të Mitrovicës, saktësisht së zonës qendër, por është edhe profit për

komunën, e cila një ngritje e koeficientit, përveçse që është interes i ndërtuesit dhe investitorit, është interes edhe në të mirë të komunës, për arsye se krijon të hyra nga taksat ndërtimore përbrenda qytetit tonë. Andaj, unë edhe një herë e këshilloj drejtorinë e urbanizmit në ato se çka dihet dhe që mendoj që është e mirë për qytetin e Mitrovicës që ta analizojë në detaje dhe të bëjë një editim shtesë, saktësisht tek zona shtatë dhe ajo pjesë e cila e përfshin zonën shtatë. Kërkoj mirëkuptimin tuaj, po unë edhe një herë kërkoj nga drejtoria që të bëjë analizë para se të futet në miratim.

Fisnik Krasniqi: Realisht ky është një ndër dokumentet më të rëndësishme që e kemi para vetes dhe e kam për detyrë të paraqes edhe një ndër kërkesat e marra nga qytetarët që është për zonën kadastrale në Vaganicë, saktësisht me zonat 00295-1 dhe 00295-4 që nga zona komerciale të kthehet në zonë të banimit individual të ulët, pra ndërtim të shtëpiave ZV 4. Siç janë edhe parcelat në afërsi të këtyre zonave.

Kushtrim Zeneli: Harta Zonale është një rëndësie të veçantë për qytetin, mirëpo mendoj se në shumë pjesë duhet të intervenohet dhe ka shumë zbrazëtira. Për shembull, po i filloj, po i përmendi disa pjesë, ku për shembull Harta Zonale mbështetet në plane të vjetra, për shembull e kemi: Planet rregulluese urbane të miratuara në vitin 2010-2014, që këto plane ishin hartuar me të dhëna demografike, ekonomike, të asaj kohe të cilat janë tashmë pjesërisht të vjetërsuara. Për shembull, në Hartën Zonale komunale citon popullsinë e komunës 71700 banor, shifër kjo që është nga regjistrimi i vitit 2011, pa reflektuar plotësisht ndryshimet demografike të dekadës së fundit. Pastaj, kemi mospërputhje me zhvillimet ekzistuese, pra kur është duke e zhvilluar ndërtimi, për shembull e kemi Zonat informale dhe urbanizimi real, ku komuna ka disa zona të urbanizuara në mënyrë informale, të cilët plani po i përmend, por që në terren vazhdojnë të jenë sfiduese. Për shembull, e kemi Lagjen e Bizneseve në Zhabar i Poshtëm, një zonë e zhvilluar me iniciativë private, biznese, depo, auto-larje, por pa plan rregullues, pastaj e kemi Lagjen e Bizneseve, objektet që janë kryesisht në gjendje të mirë, kurse në zona të tjera informale, si: Lagja Sitnica, 2 Korriku ku gjendja e ndërtimeve është mesatare, edhe këtu kanë avancuar. Këtu domethënë me ndërtime pa leje apo me plan të vjetër. Çfarë do cekja këtu është që një mungesë e përfshirjes së komunitetit lokal në procesin e planifikimit, ku gjatë diskutimeve është vërejtur se pjesëmarrja e banorëve ka qenë shumë e vogël, veçanërisht nëpër zonat rurale, sidomos në rajonin e Shalës së Bajgores, rrjedhimisht këto kërkesa dhe nevoja nuk janë paraparë në planin aktual. Mendoj që është deshtë komuna dhe drejtoria me gjet mënyra se qysh me i ftu qytetarët me marrë pjesë në debat, pas parasysh se kjo është një Hartë Zonale që përfshin një periudhë 8 vjeçare. Pastaj, një mungesë tepër që në hartë zonale dhe që nuk besoj që ish dashtë me u tejkalua është VNM-ja që është vlerësimi i ndikimit në mjedis, nuk ka një VNM më të detajuar për hartën zonale, kësaj duhet t'i kushtohet vëndësi shumë të madhe në të kundërtën, kjo mund të sjell rreziqe të mëdha mjedisore. Tutje, ende nuk e pashë këtu se ku ka pas një debat ose një konsultim me ekspertë të çështjes mjedisore, ka pas ndoshta ndonjë debat ose ndonjë tryezë me OJQ mjedisore, po nuk do të thotë që OJQ-të mjedisore patjetër kanë të përfshirë ekspert mjedisor. Pastaj, në VNM nuk janë paraparë as mekanizmat e monitorimit të ndikimit në mjedis, nuk janë paraparë as masat e ndryshimeve klimatike që mundem me ndodhë, pastaj nuk janë paraparë as zonat me rrezikim të lartë mjedisor që janë. Çfarë mundem me prekë edhe një plan që duhet me adresu në këtë Hartë Zonale, ka qenë që duhet me e lidh me barazinë sociale edhe me mjedisin. Për shembull, Mitrovica e Jugut, ne e dimë që ende ka komunitete të prekura nga ndotja me plumb, që është trashëgimi prej mbetjeve të Trepçës dhe familje e fëmijë të rrezikuar nga kjo, plani edhe pse në parim i përmend parimet mjedisore, i përmend disa rreziqe, mirëpo nuk e detajon një zgjidhje konkrete për pastrimin e truallit të kontaminuar, as rehabilitimin e deponimeve të vjetra industriale apo krijimin e deponimeve, krijimin e korridoreve të gjelbra ekologjike ose masa për zhvendosjen e familjeve që jetojnë pranë ish-industrive toksike. Po ashtu, në plan mungojnë mekanizmat për mbrojtjen sociale. Për shembull, si do të përfitonim banorët aktualë të zonave informale, kur ato do të ri-planifikohen? A do të ketë kompensime të drejta për ta, apo rrezikojnë të zhvendosim? Këto pyetje sociale nuk marrin përgjigje

në dokument. Çka unë e shoh si mangësi serioze, pra që zhvillimi urban duhet t'i shërbejë të gjithë qytetarëve veçanërisht atyre me nevojë. Edhe krejt në fund kisha me kisha me përmend edhe një çështje tjetër që po e shoh që ka mbet sikur ma herët është deponia e mbeturinave në Koshtovë të Mitrovicës, është një deponi e cila na të gjithë e dimë, edhe ekspertët mjedisorë e dinë që ajo deponi nuk ka jetë gjatësi, në hartë zonale nuk e pashë që është parapa diçka që ka me ndodhë me atë deponi e atë pjesë, kur dihet se banorët e atyre zonave e edhe bizneset që operojnë shumë herë janë të rrezikuar si pasojë e deponisë së mbeturinave.

Xhylljeta Imeri: Dua fillimisht të shpreh mirënjohjen time për angazhimin që është bërë në sjelljen para përfaqësuesve të qytetarëve të Mitrovicës, të draftit të Hartës Zonale të Komunës sonë. Megjithatë, më lejoni të theksoj zhgënjimin tim lidhur me përmbajtjen e saj, Harta Zonale, në parim, do të duhej të ishte një dokument i drejtë, gjithëpërfshirës dhe që garanton trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët, pa asnjë formë diskriminimi, fatkeqësisht vlerësimi bazuar në konsultat me ekspertë të fushës, dhe me shumë banorë të komunës sonë është se kjo hartë ka prodhuar ndjesi të diskriminimit dhe përjashtimit tek një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve. Nga analiza ime dhe nga komunikimi me qytetarët, konstatoj se kjo hartë zonale nuk reflekton realitetin aktual në komunën tonë, as nevojat reale për zhvillimin urban dhe ekonomik të saj. Përkundrazi, sjell pasoja negative në shumë zona dhe nuk i adreson drejt prioritetet infrastrukturore dhe publike që qytetarët me të drejtë presin nga ne. Duke marrë parasysh këtë situatë, si dhe duke mbështetur në parimet mbi të cilat kam kërkuar besimin e qytetarëve, theksoj se, pavarësisht skepticizmit tim për këtë proces, do të mbetem konsistente me premtimet e mia. Gjithmonë do të veproj në të mirë të qytetarëve dhe interesit publik, ashtu siç kam vepruar deri më tani. Dhe për këto arsye nuk do të jem pjesë e këtij votimi.

Vesel Neziri: Përshëndetje për të gjithë! Unë do të jem shumë i shkurtër, por do të mundohem të jem edhe i qartë. Pika e parë; në qoftë se ky dokument ka mangësi, atëherë pse Ministria e ka aprovu? Pika dy; në qoftë se kjo hartë e rregullon gjendjen, çka ka diçka që nuk e rregullon gjendjen? Në këtë hartë që unë kam mendua që nuk ka diçka të mirë, është vetëm koeficienti, i cili për shkak të numrit të banorëve na u ka reduktua, jam i bindur që edhe ekzekutivi dhe ne të gjithë kishim me e rregullu këtë çështje të koeficientit po të ishte numri i banorëve ai që ka qenë më parë. Prandaj, unë besoj shumë në atë që thonë se kjo hartë është vonuar, por nuk po mundem me e kuptu pse duhet me e vonuar ende, në qoftë se thonë se është vonë, atëherë pse duhet vonuar edhe me shume se sot? Prandaj, unë po mendoj që në qoftë se sot është vonë, nesër është shumë me vonë edhe pres që ky dokument të aprovohet.

Naser Muja: Desha të ndalem pak a shumë, sepse u thanë edhe nga parafolësit të gjitha. Të ndalem pak tek pika katër e planit që drejtori e ceku më lart, ndërtimi i rrugëve në qytet. Kur është bërë planifikimi për hartën zonale të ndërtimit, rrugë në qytet, është dashtë të merret për bazë plani i mobilitetit urban të qëndrueshëm. Unë nuk munda t'a shoh aspak që është marrë për bazë ky plan i mobilitetit që është për vitin 2020 - 2028. Në këtë plan janë specifikuar të gjitha rrugët në qytet, rrugët "Ali Zeneli", "Lah Nimani" edhe te Liqeni, e të gjitha. Rruga "Ali Zeneli", si të metë unë e kam parë se pse të ndërpritet tek universiteti e mos vazhdoet në trasenë që ka qenë në projektin e vjetër, e të dalë mbrapa stadiumit "Adem Jashari", kur e dimë se stadiumi "Adem Jashari" është në ndërtim e sipër dhe aty nuk do të ketë rrugë në afërsi të stadiumit. Tjetër pikë që deshta të diskutoj, Rruga "Lah Nimani", e njëjta problematikë shkon përfundon vetëm në rrugën që lidhet me ETC-në edhe vazhdon nga policia aty dhe del në rrugë kryesore që e shkarkon qytetin. E njëjta situatë ka qenë edhe tek Liqeni Akumulues. Ndërtimi i urës, aty është bërë zhvendosja e saj më poshtë, ka mbet në atë hapësirë, ku në pjesën e majtë të liqenit kanë qenë të parashikuara përmbi 300 vende të parkingut për automjete.

Domethënë këtu, janë brengat e mia që nuk është marrë për bazë plani i mobilitetit. Pra, kaq sa i'u përket rrugëve, shumë pak është marrë për bazë ky plan, ose mund të themi që hiç fare.

Ekrem Sadiku: Përshëndetje të gjithëve. Natyrisht se të gjithë pajtohem që ky plan ose ky dokument është tejet i rëndësishëm për qytetin. Nuk dua të përsëris disa çështje dhe disa vërejtje, të cilat i ngritën parafolësit. Unë do të ndalem në disa çështje, sa i përket mos implikimit ose mos marrjen parasysh të disa ligjeve, të cilat janë vënë dhe janë të zbatueshme në nivel vendi, dhe përpos kësaj, ajo e cila u cek edhe më herët nga parafolësit, nuk është marrë për bazë as plani zhvillimor, as plani i mobilitetit dhe as disa ligje, të cilat janë të aplikuueshme në Republikën e Kosovës.

Unë do të ndalem më specifikisht në disa dhe do të i'u jap disa rekomandime. Si për shembull, është dashur shtimi i një kapitulli të dedikuar për vënien dhe procedurën e konsultimit publik. Është dashur hartimi i kriterëve specifikë për projektet me ndikim të lartë mjedisor, të gjitha këto të parapara me Ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Nuk është bërë inkorporimi i obligimit për certifikimin energjetik të ndërtesave të reja, është dashur të inkorporohet definimi i kushteve minimale energjetike për sektorin publik, të gjitha këto në Ligjin për performancën energjetike të ndërtesave. Çaktimi i përqindjes për energjinë e ripërtitshme, që synon të arrihet deri në vitin 2030, mungon. Përshkrimi i masave për mbështetjen e vetë prodhuesëve të energjisë. Të gjitha këto të parapara dhe të inkorporuara në Ligjin për burimet e ripërtitshme të energjisë, Ligji 08L-258. Referencë specifike ndaj projektit: banimi social adekuat dhe objektivat e tij, përshkrimi i lokacioneve potenciale dhe kriteret për ndërtimin dhe renovimin, të gjitha këto të parapara në banim në Ligjin për banim social adekuat, Ligji 08L-302. Nuk janë konsultuar fare këto ligje ose për me qenë pak më realist, janë konsultuar fare pak, sepse disa pjesë janë të konfirmuara. Pak një përmbledhje të shkurtër, do të thotë të përgjegjshme mospërputhjet kryesore do të thotë edhe lidhur me hapësirat informale mes hapësirave informale dhe planifikimit formal; mes parashikimeve optimiste ekonomike dhe zhvillimit real, i cili është duke ndodhur mes infrastrukturës së planifikuar dhe asaj ekzistuese, me një fjalë, këto boshllëqe dhe veprime, kërkojnë veprime korrigjuese gjatë zbatimit, në mënyrë që ky dokument ose Harta Zonale të mos mbetet vetëm një dokument teorik, por të reflektojë realitetin.

Hysen Muzliukaj: Faleminderit të gjithëve. Nuk bën të ik dhe të mos diskutoj, sidomos në këtë pikë. I dëgjuam të gjitha, pra u thanë të gjitha, mirëpo nëse veç më dëgjoni me vëmendje, lexoni titullin propozim vendim për miratimin e hartës zonale të Komunës së Mitrovicës 2024 - 2033, pasi sot vjen kjo pikë t'a kemi me dije që sot është 28.04.2025, a po i bie që një vit i shkoi hartës zonale? Thjeshtë t'a keni logjikën të gjithë, edhe t'a shikoni me vëmendje. Vërejtjet e mia janë qysh prej fillimit për këtë punë, kam edhe mendime pozitive, nuk është që kam vetëm negative, a do duhej të ketë Hartë Zonale, patjetër se po, nuk besoj që ndonjë prej ne është kundër miratimit të një dokumenti që e rregullon ndërtimin, e rregullon qytetin. Mirëpo a besoj që edhe kompania, edhe ekzekutivi kanë çalu në leximin e dokumenteve dhe përcjelljen e datimit. Pse ka ndodhë kjo? Po, është edhe titulli këtu edhe janë përmendë pak a shumë është bazuar në Planin Zhvillimor të komunës, ministria e lëshon këtë dokument, është bazuar në Planin Zhvillimor 2023 - 2031. A ke në proces që ne i'u kemi drejtuar që e keni gabim? Ligjërisht si institucion do duhet t'i drejtoheni ministrisë që këtu e keni gabuar, se plani zhvillimor është 2020 - 2028, e nuk është 2023 - 2031. Tjetra, në pëlqimet fillestare, pse dua të jap kritikën time në aspektin profesional edhe juridik? Çdo dokument që përmendet, çdo vendim që përmendet, Kryetari ka qenë edhe Ministër, do të duhej bashkëngjitje të lëndës. Këto bashkëngjitje në lëndë, ne duhet t'i kishim secili, këto dokumente edhe t'i shfletojmë. Do të duhej t'i kishim edhe ato pas përkthimit, prej ministrisë, nuk e kemi, po flasim në ajër. Nëse flasim në ajër, atëherë ka mendime, ti doli më mirë, ti doli më keq. Pse po them këtë? Vendimi, kryetar, dua të korrigjoj edhe ty pse e nisa kështu në 2024 - 2032, shkresa është e dërguar 13.11.2024, më shkon prej drejtorit në Komitetin për Politikë dhe Financat se shkresa ka arritur me 20.11.2024. Ajo puna e 30 ditësh, po dakordohemi që nuk po e thotë, po që t'a zëni këtë 2024-in do të duhej që t'a procedonit në Dhjetor të 2024. Kryetar, personalisht jemi duke i'u thënë, çka kemi me i'u thënë, se një vit shkoi. Nëse sot kjo votohet, një vit u eliminua. T'a keni me dije, vendimi është 2024 - 2032. Ne jemi 2025, 2024 iku. A do të duhej të votohej, këtu në këtë sallë besoj ke edhe jurista. Nuk votohet në kthim, nuk

votohet për vitet që kanë shkuar. Ne votojmë për vitet që vijnë, për vitet pasuese, jo për vitet që janë shkuar. Tash, për mua si jurist kjo është diskutabile. Japim mprehtë kontra-mendime e mbajmë edhe punëtorin në këtë raport, po nuk do të doje një dokument i tillë të vinte 2025 dhe të votohej për 2024 - 2032. E kuptoj se ua paskan vonuar në nëntor. Po ju, nuk është dashtë me vonua e me sjellë në dhjetor, për me e zënë 2024. Tjetra, vendimi i MPH-së, është i dt. 23.02.2023 për pëlqimin mjedisor për raportin për vlerësim strategjik për Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2023 - 2027 edhe drejtori, edhe kompania do duhej të na jepnin sqarimet e duhura pse përmenden këto vite, këto data sepse është shpërputhje totale, më besoni se edhe qytetarët që janë duke na përcjellë. Është kthyer tema vetëm në nivel të koeficientit nuk do të duhej Harta Zonale të kthehej në nivel të koeficientit a është 3, a është 2.5, 2.8 apo 4. Është më shumë se koeficienti, Harta Zonale. Drejtorë, edhe ju kompania që jeni këtu do duhej t'ia shpjegoni qytetarëve që nuk është temë e Hartës Zonale vetëm koeficienti, do të duhej t'ia shpjegoni ku kanë me u hapë rrugë të reja, shtigje të reja. Nuk e kemi, më besoni, krejt këto ditë është folur vetëm sa ka me qenë koeficienti, a më konvenon mua, a nuk më konvenon mua. Nuk është tema e Hartës, nuk është Harta Zonale kështu dhe s'duhet me i kuptu dokumentet qencësore të komunës, ka mospërputhje me Planin Zhvillimor. Drejtor, tani i'u sfidoj me pyetjen që u përmend më herët, në atë projektorin aty, Kompania le të lëshon ku është QKMF-ja e re, ku parashihet të jetë? Dhe qysh shihet QMF-ja e Iliridës, a parashihet. Në këtë hartë zonale që e keni sjellë ju, thjeshtë n'a demantoni, na faktoni me gjuhë të argumentit, e ngrisim dorën, edhe ne jemi njerëz, mund të gabojmë. Veç profesionalisht, nëse flasim për një dokument, këtu tash pse ka mospërputhje. Krejt Harta Zonale është punua me popullsinë e komunës që paraqet shifra 71900 banorë, kjo është e vërteta, sot i ke 64.000 banorë, nuk figuron realiteti. Unë profesionalisht jam duke i dhënë vërejtjet e mia, po them, flisni e më mbushni mendjen, jemi këtu, n'a tregoni për QKMF-në, ku parashihet me u ndërtua në bazë të hartës zonale, kjo QMF-ja e Tavnikut, çfarë parashihet të jetë në Tavnik, edhe n'a tregoni paksa për ambulancën në Koshtovë, dhe n'a tregoni se ku parashihet në Hartë Zonale ndërtimi i bibliotekës "Latif Berisha". Ju pres tani në projektor, të më shpjegoni më gjerësisht.

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Besoj që përgjigjet do mundeni t'i merrni më pas nga drejtori. Dikush tjetër.

Erseka Barani: Përshëndetje të gjithëve. Pa dyshim që është dokumenti më i rëndësishëm sa i përket zhvillimit të qytetit, dhe personalisht do të isha shumë e lumtur në qoftë se kjo hartë do të ishte funksionale dhe t'i përmbushte nevojat reale dhe konkrete duke i inkorporuar ndryshimet të cilat kanë ndodhur prej draftit paraprak. Megjithatë parafolësit përmenden dobësitë esenciale të këtij dokumenti, shqetësimet në mes të tjerash, janë edhe në fushën e infrastrukturës publike dhe asaj sociale. Parqet publike dhe hapësira të hapura ku parashihet me këtë Hartë Zonale, mirëpo në këtë betonim, që është bërë zonës urbane shumë vështirë edhe me i parapa hapësira për shërbimet mjekësore, siç u tha.

Pra, do të thotë QKMF-ja e re që tashmë është ndërtuar mirëpo në Hartë Zonale, figuron në një tjetër destinacion ose në një tjetër zonë është prej 8700 m², ku i është prerë shiriti në Janar para zgjedhjeve, dhe ende nuk është funksionalizuar, Kryetar, ndërtimi i muzeut përballë shtëpisë së ish-armatës, ku faktikisht në emër të interesit publik është dhënë ajo parcelë por ende po figuron në këtë dokument, do të thotë nuk është bërë, nuk janë bërë ndryshimet esenciale të zhvillimit të qytetit. Rritja e fondit të gjelbër për kokë banori duke rritur sipërfaqet e gjelbëruara në zonën urbane ku faktikisht vetë banoj në rrugën kryesore "Mbretëresha Teutë" dhe është totalisht e betonuar, edhe pse është ndërtuar së fundmi, por e pa pranuar ende, mos të flasim që në këtë dokument nuk parashihen edhe mbylljet e shkollave në zonat rurale që kanë ndodhur. Praktikisht, mendoj që qytetarët kanë të drejtën të jenë të informuar rreth këtyre ndryshimeve dhe kanë të drejtën që të paktën ky dokument t'i plotësoj nevojat esenciale të tyre, dhe ne si përfaqësues mendoj që duhet të votojmë në bazë të interesit, që qytetarët kanë dhe realisht jemi përfaqësues të interesave të tyre.

Kryetari i Komunës Z. Bedri Hamza: Faleminderit Kryesuese! Fillimisht duke i falënderuar të gjithë asamblistët për diskutimet e tyre unë i konsideroj që të gjitha janë qëllim mira, normalisht që nëse ka diçka që të korrigjohet e përmirësohet gjithmonë duhet me qenë të hapur dhe duhet me qenë edhe diskutimet edhe propozimet edhe kritikën të mirëpritura. Mirëpo, siç e dini edhe ju, edhe unë, ky dokument, nëse diçka s'ka qenë në harmoni, po flas për këtë anën ligjore, ky do të shkojë edhe për konfirmim të ligjshmërisë, nuk është vendimi i Asamblesë komunale, pavarësisht pa paragjykuar rezultatin e votimit, nuk është përfundimtar, sepse do të bëhet konfirmimi i ligjshmërisë dhe besoj që ministria kompetente, në këtë rast Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do e dërgoj edhe ministrit të Linjës, cilat kanë ndërlidhje me këtë dokument për të konfirmuar ligjshmërinë e këtij dokumenti dhe këtij procesi dhe jam i bindur që kjo do të shikohet dhe insistoj që të shikohet në detaje. Zonja Barani, po të tregoj që ke qenë drejtoreshë, aq sa ke qenë, Po për 4 vite. Më thuaj të lutem, me mirësjellje po të drejtohem unë, sa ambulanta, sa QMF-ja janë filluar, janë përfunduar, e janë rinovuar, në mandatin tuaj si drejtoreshë? E sa i përket QKMF-së, është përfunduar normalisht që edhe infrastruktura përcjellëse këtë rast, për shkak se është konstatuar që u tha edhe më herët, në zona të caktuara infrastruktura ka qenë e dizajnuar e ndërtuar për ndërtime të ulëta dhe është konstatuar që infrastruktura e kanalizimit, rrjeti energjetik kanë pas nevojë për investime shtesë, me qëllim që mos të prodhohen probleme në momentin kur të kalon stafi atje, mobilimi është duke ndodhë, stafi është duke u bartur duke disloku dhe nuk është një objekt, nuk është një punë, nuk është një institucion, i cili mundet me u bartë brenda një jave apo dy jave. Unë pres që gjatë Majit qytetarët e Komunës së Mitrovicës të fillojnë t'i marrin shërbimet në QKMF-në e re. Megjithatë jam i bindur që është një objekt korrekt që krijon kushte të mira për pacientë edhe kushte të mira për të punësuarit në Komunën e Mitrovicës. A sa i përket, prapë po e ritheksoj, ligjshmërisë të këtij dokumenti, unë kërkoj, jam shumë i hapur, e mirëpresë, çdo vërejtje, çdo kërkesë nga institucionet përkatëse, këtë rast nga ministria kompetente, Ministria e Administratës të pushtetit lokal, edhe Ministrinë e Linjës, kudo që ka pas ndonjë shmangie kudo që ka ndonjë diskrepancë, kudo që nuk është e harmonizuar me ndonjë ligj. Kudo që ka probleme, që edhe mund të vijnë te dilemat se a duhet që kjo datë a nuk duhet që kjo datë, a duhet me u bazua në këtë dokument a nuk duhet me u bazua në këtë. Unë mirëpres çdo vërejtje që morëm për ata, nëse ka nevojë me u inkorporu edhe nëse mundet me u inkorporu, ka me u inkorporu. Nëse ka nevojë njëjta gjë të sillët prapë për diskutim në asamble komunale, e të kalon në rrugë tjetër, jam shumë i hapur! Prandaj, e thashë në fillim, edhe po e përmbylli. Qysh voton, individualisht, si grup politik, secili prej juve, unë e vlerësoj të drejtën e juve. është në diskrecionin juaj, dhe jam i bindur që diskutimet nuk ish dashtë edhe këto që kanë qenë s'po them kritik, apo me rekomandime për të bërë më i mirë, me i marr me sinjeritet edhe seriozitet jo me i marrë asesi tendencioze ose qëllimkëqija. Nëse thotë dikush që ky dokument për këtë arsye, për këtë është kështu, atëherë merre me kujdes edhe nëse ka nevojë edhe ka hapësirë dhe ka mundësi me i inkorporu në proces e inkorporon. Edhe një herë, faleminderit shumë, ju jam mirënjohës por nganjëherë kur po dilni prej temës të Hartave Zonale, po më qitni edhe mua nga tema.

Erseka Barani: Faleminderit Kryetar! Praktikisht, nëse dëshiron, ne mundemi edhe me e kthi, e t'i bëjmë një raport Drejtorisë së Shëndetësisë se çka ka bo Drejtoria e Shëndetësisë para 4 vitesh? Faktikisht, Drejtoria e Shëndetësisë nuk po na raporton neve se çka ka bërë katër vite për këtë punë, megjithatë, është e vërtetë që në një prej kërkesave kryetari, e ka aprovuar që nuk ka pas të bëjë me ndërtimin e QKMF-së, ka qenë një donacion tjetër që kemi kërkuar dhe e ka aprovuar këtë edhe publikisht e kam falënderuar për këtë kërkesë që e ka realizu si ministër i Financave, në atë kohë, po janë mbi 4 kërkesa që janë adresuar për ndërtimin e QKMF-së të re dhe për asnjë nuk është marr asnjë përgjigje. Në vitin 2018-2019, dy vite, pra gjatë asaj kohe kam qenë unë drejtoreshë. Në rregull dhe paraprakisht në atë kohë kanë qenë. Megjithatë, ato janë, evidente. Ne kërkesat i kemi, ato janë edhe në arkivin e ministrit sigurisht, mirëpo nuk kemi marrë përgjigje për atë punë. Para disa mbledhjeve, Kryetar, vetë ke thënë që nuk kam dashtë t'a aprovoj, sepse kur të vi unë, kam dashtë me e bërë QKMF-

në, dhe këtë e ke bërë. Ashtu që do të thotë, totalisht, vendim politik, e para. Është e vërtetë që i'u ka ndërruar destinacioni prej aty fillestar që na e keni bërë. Absolutisht, është e vërtetë që ky objekt është tash, natyrisht që vonon, sepse nuk i plotëson as kriteret, esenciale duke e marrë parasysh Hartën Zonale - komunale, njëkohësisht janë 8700 metra katrorë, që është totalisht e madhe në krahasim me nevojat e shërbimet që po merren, Kryetar dhe ndoshta do ishte më mirë me përgjysmua atë metrin katror, edhe shumë më shpejt ish funksionalizuar, edhe shumë më shpejt kishit mundur edhe pajisjet me i marrë. Kështu që, po pas raportit të drejtorit për Shëndetësi edhe unë mundem me japë raport për drejtorinë për Shëndetësi, çfarë ka ndodhur para 4 vite, se cilat projekte janë realizua.

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Me mirëkuptimin më të madh, lus asambleistët që të mos dalin nga rendi i ditës, përderisa kemi një rend të ditës mjaft të rëndësishëm. Faleminderit! Kryetari e ka fjalën, pastaj vazhdojmë tutje.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Dua të shpjegoj në pika të shkurtra procedurat buxhetore. Nëse kërkesa bëhet në vitin 2019, e njëjta proceduralisht dhe ligjërisht mundet me u bë pjesë e buxhetit të vitit të ardhshëm, nuk mundesh të bësh kërkesë në vitin 2019 edhe me u bo pjesë e buxhetit në vitin 2019. Kështu që, nëse u bë kërkesa në 2019, qeveria kushdo qoftë ka mundur të trajtoj në procedurat e rregullta buxhetore për vitin 2020, jo ndryshe.

Hamdi Hasani: Përshëndetje për gjithë të pranishmit. Sinqerisht është për çudi edhe paksa i keq qëndrimi jonë, çka jeni kaq të unifikuar ndaj një pike kaq të rëndësishme për qytetin, secili në fjalimin e tyre kolegët nga Vetëvendosja, të parën fjalë kishin që është ndër propozimet dhe projektet më të rëndësishme të qytetit, kur ia sheh arsyetimet janë qesharake se për çfarë nuk e përkrahim këta. Zoti Mujka, apo qysh po e quajmë disa media meraklia i keshit. secili duke i ndenjur gati çka po ndodhë e pse po ndodhë, vetëm një gjë po ju them unë sot, e di që ka burra të mirë, miq të mirë, edhe gra të mira, dhe po e di që sot ju nuk jeni vetëvetja, a keni marrë direktiva të qarta, komplet grupi, a keni marrë kërcënim që komplet që ai që voton këtë propozim, nuk do të jetë në listë, bëhuni të sinqertë, tregoni, sepse arsyetimet tuaja nuk është për çudi se në nivel qendror ju kështu bëni, dhe çdo gjë që është e rëndësishme për shtetin, ju keni vetëm synimin politik, përfitimin politik, dhe u krye. Tjetra, nuk e di pse na thotë pa pikë turpi ne se jemi vonuar, kur vet kanë qenë në pushtet prej 2013, e vet e kanë sjellë në 2020. Domethënë, 7 vite vonesë, e kanë sjellë këtë plan, neve na thotë pse jeni vonuar deri tash. Thuani një herë para qytetarëve, se ju nuk na interesoni po vetëm qëndrimi jonë politik, nuk na intereson as qyteti, as propozimet, na intereson vetëm si të bëjmë keq, por të mbahemi në pushtet, dhe kaq. Unë nuk mundem ashtu.

Kryesuese e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Ju ftoi të vlerësoni mendimin e njëri-tjetrit, ju lutem!

Xheva Bahtiri: Kryesuese, sa i përket Hartës Zonale, vërtet nuk kam desh me marrë fjalën ende, sepse janë një numër i madh i pronave që kemi në atë pjesë që shtrihet qyteti. Nuk kam deshtë të marrë fjalën fare, por diçka që është duke më penguar, që 4 vite çdo person që fol me gjithë respektin e botës për mësuesen Nafije, por nuk po mundem me u koncentrua. A me u koncentru se çfarë është pika në rendin e ditës apo me e dëgju vetëm mësuesen. Nuk është në rregull sepse vetëm ty po të dëgjojmë, të gjithë ne po heshtim. Mësoni të jepni të drejt fjalë.

Nafije Rexha: Kam qenë 4 vite opozitë edhe kam qenë bashkë me juve, kështu që me të vërtetë nuk po mundem as me i'u kuptu, kur po flisni rreth kësaj teme, po flisni gjithmonë në kundërshtim me vetveten, në atë që s'e keni bërë ju, po na akuzoni neve. Fatmirësisht, Kryetar, faleminderit për çdo veprimtari dhe punë e projekt të rëndësishme dhe ju dhe ekzekutiv i nderuam, që i keni jap një frymë ndryshe. Kështu që raporte, e din edhe Fadili e din edhe Vesa, kemi qenë pjesë e opozitës bashkë. Sa herë kemi kërkuar raporte, asnjëherë nuk na i keni sjellë. Sa herë kam kërkuar çështje të ndryshme, asnjëherë nuk na është jap mundësia kaq gjatë, prej kryesuesve paraparak, të arsyetohemi kaq shumë si opozita. Faleminderit!

Kryesuesja e Kuvendit Vesa Broja: Me sa e di me diskutime e kemi përfunduar. Po, për ndonjë përgjigje apo diçka, po e ftoj drejtorin të përgjigjet.

Nexhmi Hasani: Të nderuar të pranishëm. Unë jam Nexhmi Hasani, shef i sektorit të planifikimit, dhe jam menaxher i Hartës Zonale. Unë po e shoh pak që në njëfarë mënyre po i ekzagjeroni sendet, sepse Harta Zonale është një dokument, i cili bazohet në Planin Zhvillimor Komunal. PZHK është plan strategjik. Ne e kemi miratua Planin Zhvillim 2022-2028, ndërsa në vitin 2021 ne e kemi nënshkrua Kontratën për hartimin e Hartës Zonale. Departamenti i Planifikimit Hapësinor në Prishtinë e pranon që Komuna e Mitrovicës e ka hartën zonale dokumentin më të mirë në nivel vendi, kurse procedurat në nivel vendi, dhe zvarritja që na e ka bërë Departamenti i Planifikimit Hapësinor ka zgjatë jo më pak se dy vjet e gjysmë. Domethënë, si ish-menaxher, krejt i kam dokumentet që na kanë kthyer mbrapa. Çka ka ndodhë? më është deshtë me intervenu te sekretari permanent, me e-mail zyrtar që po na u bëhet një padrejtësi, për të cilën arsyet unë nuk i di, mirëpo një padrejtësi prej Departamentit të Planifikimit të Hapësinor dhe vetëm kur ka intervenua sekretari në Departament të Planifikimit Hapësinor, pastaj na u ka lëshu pëlqimi. Pra, ka pas zvarritje të hatashme, ne me drejtorin kemi qenë shumë herë në departament, kemi pas rast, që na e ka kthyer mbrapa duke thonë se e keni një hidrocentral, ku hidrocentralit ju ka lëshu leja para dymbëdhjetë viteve dhe është në Plan Zhvillimor Komunal me koordinata. Pastaj, planet rregulluese dhe Ligji për Planifikim Hapësinorë të dispozitat kalimtare, neni 36, paragrafi 7 thotë: Planet rregulluese mundën me u përdorë derisa të dalin këto të reja, kurse paragrafi 8 thotë: aktet nënligjore të Ligjit të vjetër mund me i përdorë, nëse nuk janë në kundërshtim me aktet nënligjore të Ligjit të ri. Atëherë, përderisa Planet Rregulluese janë punua me norma të "Jusit", "Dinit" dhe "Sashit". Pra Harta Zonale është punuar me norma teknike të Kosovës, që janë miratua në vitin 2017. Planet rregulluese janë miratuar me norma të shteteve të huaja, nuk janë miratu nga normat tona, kështu që ne si drejtori jemi të obliguar me i zbatua vendimet e kuvendit komunal, por edhe vendimet e Ministrisë së Linjës. Ne prej Ministrisë së Linjës kemi lëndë që na e kthen, thotë në rastet kur nuk përputhet Plan Rregullues me Planin Zhvillimor Komunal të ri, i jep kushte deri sa të miratohet Harta Zonale, pra është vendim. Kemi pas rast që lëndën e kam qu deri në gjykatë, mirëpo gjykatë e thotë ti je shkallë e pare dhe ti duhet me zbatu vendimin e shkollës së dytë. Me ç'rast, shkalla e dytë të obligon me dhënë kushte. Tutje, në vitin 2020, Kuvendi Komunal e ka miratua një vendim në këtë sallë, që thotë: Rugët "Ali Zeneli" edhe "Lah Nimani" shpallen me interes të përgjithshëm. Edhe thotë: *Të gjitha parcelat, të cilat shtrihen në profilin e rrugëve "Ali Zeneli" dhe "Lah Nimani", me qëllim me u shpronësua, mundem me rritë koeficientin deri në 4 e gjysmë*, pra, ne si komunë nuk kemi pas buxhet me bo shpronësimin e rrugëve "Ali Zeneli" dhe "Lah Nimani", mirëpo cila ka qenë alternativa? E vetmja alternativë ka qenë ngritja e koeficientit. Domethënë ne jemi duke u bazu në vendim të Kuvendit Komunal të vitit 2020.

Të jenë të bindur se edhe Ministria e ka kuptuar që vlerësimi strategjik mjedisor i Hartës Zonale ka qenë gabim. Në ligj thuhet: *vlerësimi strategjik mjedisor bëhet për plane strategjike*. Plan strategjik është Plan Zhvillimor Komunal, nuk është Harta Zonale plan strategjik. Harta Zonale është derivat i Planit Zhvillimor Komunal. Megjithatë, ka kërkuar Ministria, atëherë ne e kemi bërë për katër vite. Sipas Ligjit thuhet: Harta Zonale nëse nuk realizohet brenda katër viteve 40%, atëherë Harta Zonale shkon në revidim. Diçka duhet me u kuptua, se jashtë Ligjit, asnjë drejtori nuk guxon me dal, përderisa Ligji thotë për komunat të cilat kanë banorë më pak se 100.000 banorë, koeficienti maksimal është tre ne nuk guxojmë me dalë jashtë Ligjit, sipas Ligjit, koeficienti maksimal është komuna që kanë më pak se njëqind mijë banorë, është tre, dhe vetëm pasi të miratohet Harta Zonale duhet me bërë Rregulloren për bonuse.

Kur e kemi bërë Planin Zhvillimor, komuna e Mitrovicës i ka pas 71000 banor rezident, dhe me ato shifra e kemi përgatitë planin zhvillimor komunal po Harta Zonale nuk e ka komponentën e demografisë. PZHK-ja e ka pas komponentin e demografisë, ndërsa Harta Zonale jo. Tutje, Qendra e Mjekësisë Familjare, është lëshu në bazë të planit rregullues Qendra. Në plan rregullues shkruan hapësirë e dedikuar institucionale. Pra, edhe në protokoll dhe në leje, bazohet në planin rregullues Qendra. Komuna e Mitrovicës i ka 331 km², 33100 hektarë.

Kryesuesja e Kuvendit Znj. Vesa Broja: Me diskutime kemi përfundua. Po vazhdojmë me proces të votimit. Atëherë, kush është që propozim vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës Jugut 2024-2032 të miratohet.

Rezultati i votimit: 17 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Miratohet Vendimi për miratimin e Hartës zonale të Komunës së Mitrovicës Jugut 2024-2032.

Pika 3

Kryesuesja: Po vazhdojmë me pikën e radhës së rendit të ditës: Propozim vendim për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale për Diakoni Kosova. Po e hap pikën për diskutim.

Po shkojmë në pauzë deri në ora 13:30.

Pauza 12:36

Mbledhja vazhdoi në ora 14:00

Kryesuesja konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm 22 anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova

Faruk Mujka: Mendoj që nuk ka tash diçka të jashtëzakonshme, e jashtëzakonshme ka qenë mënyra qysh Diakonia e ka shfrytëzua këtë pronë prej vitit 2010 apo 2011, sepse këta kanë ardhur për të kërkuar vazhdimin e shfrytëzimit po fatkeqësisht ne nuk kemi mundur me gjet atëherë asnjë vendim të Kuvendit që ju ka dhënë me Kuvend. Tash, kjo i bie që po startojmë prej fillimit, bazuar në kërkesë të Ministrisë e na prej praktikave që i kemi zhvillu më përpara sa herë që ka ardhur një kërkesë prej ministrisë, atëherë e kemi procedua me anashkalim të procedurave, nuk ka kurrgjë që ish dashtë me shtua më shumë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Propozim-vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova.

Rezultati i votimit: 22 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova.

Pika 4

Kryesuesja para se të hap diskutimin lidhur me Kërkesën e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare, theksoi se e keni pa edhe në konkluzion që komiteti e ka kërkuar njëfarë plani se qysh kanë me u shpenzua ato paratë edhe ai plan ka ardhë para pesë minutave edhe është në printim.

Kryesuesja hapi diskutimin.

Faruk Mujka: Po më duket që vitin e kaluar e kena pas një momentum të tillë, po ka qenë një kërkesë për me i mbulua do borxhe të viteve të kaluara edhe jena marrë vesh që është hera e fundit që vjen për shqyrtim në Kuvendin Komunal një kërkesë e tillë. Planifikimi buxhetor është bërë, sindikata e ka ditë ku është vendi me kërkuar mjetet për aktivitetet e tyre, ky dokument është "copy paste" prej dhjetë viteve të fundit, vizita në Bashkinë numër një, vizita në Bashkinë numër dy, vizita në Bashkinë numër tre, kjo është punë hajgaresh edhe unë thjesht nuk mendoj që duhet me qenë as pikë e rendit të ditës. Jena marr vesh me u përmbyll këto borxhe edhe prej vitit të ardhshëm gjithkush e di punën e vet edhe kah duhet me shku këto paratë. Me gjithë respektin për të gjithë punëtorët shërbyes të Komunës, unë mendoj që e kanë edhe anëtarësinë, e kanë edhe buxhetin, hajde të kish ardhur për tu paguar shujtat komunale e kuptoj, po tash me ardhë me ju pagua një ekskursion tri ditorë në Durrës edhe vetë kisha pas me dëshirë me shku, po s'po m'i paguan kurrkush.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Kërkesën e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare.

Rezultati i votimit: 16 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.
Miratohet Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare.

Pika 5

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Kërkesën e DKA-së për subvencionim të monografisë “Nxënësit e vrarë në Mitrovicë gjatë luftës së fundit.

Faruk Mujka: Kryesuese, a mundem na veç njëherë me vërtetu a kemi të drejtë ne si Kuvend me jep subvencione, na ka pas ardhë një herë një kërkesë e tillë, Kuvendi nuk subvencionon projekte, nuk merret me subvencione. Në qoftë se jena marrë vesh një herë, unë nuk e kuptoj pse duhet secilën herë me na sfidu me këto çështje të tilla. Po na bini në pozitë të palakmueshme. Jena marrë vesh, nuk ka subvencione, i kanë drejtoritë buxhetet e veta, ato që merren me subvencione, në qoftë se është nevoja edhe i votojmë, por po sfidohemi që me i ra mas vendimeve tona edhe vendimeve tuaja. Unë, parimisht nuk jam për edhe pse e di që është shumë libër me rëndësi, po veç të dimë a kemi të drejtë, e dimë që na ka ardhë gjetje prej auditorëve që nuk kena të drejtë me i subvencionua.

Kryetari Bedri Hamza: Unë po e shoh vullnetin e të gjithë asamblistëve prezentë, që është diçka e rëndësishme dhe po pajtohem që është e rëndësishme dhe vlen të përkrahet, po unë po propozoj që të shikohet mundësia me u përkrah prej drejtorive përkatëse edhe normalisht që e ka mbështetjen e Kuvendit që drejtoritë me e kryer këtë punë, po gjithmonë duke respektu Ligjin dhe procedurat në fuqi. Prandaj, nëse ka mundësi edhe shumë besoj që ka mundësi me u gjetë mjetet financiare brenda për brenda buxhetit të Komunës së Mitrovicës por gjithmonë e them që duhet me u respektu Ligji, procedurat. Kuvendi shihet që ka vullnet politik për me e përkrahë si kërkesë, ndërsa mbetet obligim në këtë rast i Drejtorisë së Arsimit apo Drejtorisë së Kulturës, që me gjetë formën e financimit të këtij projekti, por besoj që kjo është Rruga më e mira. Se nëse është bërë njëherë një vërejtje prej auditorëve e njëjta nëse përsëritet prapë, bile është vërejtje e përsëritur.

Kryesuesja Vesa Broja: Kësisoj kërkesa në fjalë i shkon drejtorisë për me shiku mënyrat se qysh mundet drejtoria përkatëse me e përfundua si proces. Atëherë po vazhdojmë me pikën e radhës.

Pika 6

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara të vitit 2024 dhe viteve paraprake në vitin 2025.

Erseka Barani: Në KPF e kam parë që Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport i ndahen prej subvencioneve mbi 129.000 €, duke e ditë që Drejtoria për Shëndetësi vitin e kaluar i ka pas subvencione 120.000 € që ua kanë dhanë njerëzve në nevojë me probleme shëndetësore, tu e ditë që qytetarët po ballafaqohen edhe në mungesë të theksuar të barnave këtë vit dhe se Drejtoria për Shëndetësi ka të ndamë vetëm 80.000 € Kërkoj, në mirëkuptim edhe të Kryetarit edhe të anëtarëve të Asamblesë, që prej atyre 129.000 € që ndahen për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, të ndahen 20 mijë € për Drejtorinë e Shëndetësisë në kategorinë e subvencioneve, në mënyrë që të paktën me iu lehtësua pak gjendja edhe Drejtorisë për Shëndetësi, por edhe qytetarëve të cilët kanë probleme ekonomike dhe shëndetësore, pra me u përkrahë pak më shumë Drejtoria e Shëndetësisë përmes subvencioneve.

Fahri Shabani: Sa për njoftim, e nderuar anëtare e Kuvendit, Drejtoria për Shëndetësi e ka kryer subvencionimin e qytetarëve për vitin 2025, atyre cilët kanë paraqitur kërkesa për subvencionim, i kemi subvencionuar të gjithë qytetarët që kanë paraqitur kërkesë për subvencionim dhe që kanë pasur sëmundje malinje, sëmundje kanceroze, qytetarët apo fëmijët që janë me aftësi të kufizuara si dhe qytetarët të cilët për shkak të sëmundjeve ose paafësisë shëndetësore gjenden në regjim shtrati apo thënë më thjesht të paralizuar. Gjithashtu edhe një numër të tjetër të qytetarëve me sëmundje tjera,

por që kanë qenë në kushte të rënda sociale, sipas dokumentacionit që e kanë paraqitë. Si Drejtori e Shëndetësisë, në bazë të vlerësimit që i kena bërë edhe viteve të kaluara, sepse para katër viteve kjo shumë ka qenë vetëm 30.000 €, ju e dini, tash është shumëfishua, mendoj që e kemi bërë një subvencionim të arsyeshëm në bazë të nevojave të qytetarëve, pa dashtë me konkluduar këtu që ne nuk mund t'i plotësojmë të gjitha kërkesat që qytetarët fatkeqësisht i kanë.

Erseka Barani: Unë desha me ta lehtësua pak punën drejtor, po pasi po i refuzon, s'kam çka të bëj. Unë jam çdo ditë në terren edhe takoj qytetarë të ndryshëm të cilët janë përkrahë më herët prej Drejtorisë për Shëndetësi, unë e di që jemi në muajin prill, deri në muajin dhjetor besoj që ka me pas edhe qytetarë tjerë që kanë këto problematika financiare që ekonomitë familjare po ballafaqohen kohëve të fundit, mendoj që qytetarët me probleme shëndetësore duhet të jenë prioritet mbi të gjitha edhe të merren parasysh kërkesat e tyre. Kështu që mendoj që është një kërkesë solide, një kërkesë që do t'i ndihmonte qytetarëve dhe besoj që edhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sport pajtohet me këtë propozim.

Hysen Muzliukaj: A mos bëri gabim drejtori kah e citoj "se e kemi përfunduar për 2025", ka menduar me thënë për 2024, edhe pyetja jem është a s'po doni me i pranua këto sa po propozojmë ne, as qysh është ideja.

Fahri Shabani: E para, nuk kisha dashtë që kjo çështje mu shfrytëzua për politikë, sepse është diçka shumë humane, një nevojë shumë e madhe e njerëzve jo vet në komunën tonë po në gjithë Kosovën që kanë nevojë për barna, tu e ditë që trajtimi i barnave është çdo ditë, secili qytetar i Kosovës që blen barna e din që ka shtrenjtim të barnave, fatkeqësisht, ish dashtë me kanë e kundërta. E dyta, ne i kemi paraqitë kërkesat buxhetore, po na e dimë që Komuna i ka katërmëdhjetë drejtori edhe ka nevoja të tjera, unë po ju them që gjithë buxhetin e komunës me dërgua në këtë kategori të subvencionimit, prapë s'ka me i plotësua nevojat. Po na urojmë që sistemi shëndetësor të zhvillohet, qytetarët të marrin shërbimet shëndetësore të nevojshme, të kenë barnat dhe tretmanet e tjera të nevojshme dhe mos të harxhojnë nga xhepi i tyre.

Erseka Barani: Përderisa ka mungesë të theksuar edhe nëpër barnatoret e QMF-ve edhe në QKMF të furnizimit me barna kështu që unë kam mendu që është një lehtësim për qytetarët dhe absolutisht në asnjë formë nuk kesh duke bërë politikë, kesh duke ta lehtësu edhe ty punën e përditshme që e ke me palë, njëkohësisht edhe me i lehtësua ata qytetarë që kanë probleme shëndetësore. Për mua më prioritet duhet me pas gjendja shëndetësore e qytetarëve, e pastaj senet tjera. Mos të flas që prej thirrjeve publike të DKRS-së, ka mungesa të theksuara të raporteve të OJQ-ve, të raporteve të klubeve se si i kanë shpenzuar mjetet sa herë që janë subvencionu. Desha që të paktën 20.000 € me u nda në kategorinë e subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi, meqenëse po i refuzon OK.

Fahri Shabani: S'mund me lejua me thanë po i refuzon, nuk ka njeri normal që refuzon ndihmesën për këtë kategori, mos të ketë keqinterpretim. A është mirë që po politizohet, nuk është mirë, në vitin 2021 për këtë kategori janë dhënë tridhjetë mijë €, edhe kemi qenë në kohën kur kemi dalë nga pandemia apo kemi qenë ende në situatë të pandemisë, mirëpo nuk po dua me e politizu, subvencionimi është rritë, janë ekzekutua pagesat të premtën dhe sot thesari i ka ekzekutua të gjitha pagesat për 700 qytetarë të cilëve komisioni ua ka miratua kërkesat. Ka edhe qytetarë që nuk ju ka miratua kërkesa, mirëpo me një sëmundje të diabetit kur kontrollin te mjeku familjar e ka pa pagesë, të gjitha analizat i ka pa pagesë, të cilat parashihen me Udhëzimin Administrativ për kujdesin parësor shëndetësor dhe një numër të madh të barnave e merr pa pagesë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, mendoj se si qeverisje komunale e kemi kryer obligimin të cilin e kemi ndaj këtyre qytetarëve. Nevojat janë ekstremisht të mëdha, po mundësitë janë këto që janë.

Xhevrije Bahtiri Ademi: Gjithkush po flet në profesionin e vet dhe unë dua me fol diçka. Unë mendoj që vërtetë kërkon mbështetje mjekësia por unë e kam thënë më herët edhe sa herë që të më ipet rasti, e përsëris, kemi nevojë për ndonjë punë apo për ndonjë projekt që rinia të aktivizohet në aktivitete sportive, në aktivitete fizike, me të vërtetë Kryetar, nuk mundesh me besu në cilën shkallë

kemi ardhë se jam aty dhe po i shoh edhe unë kisha pas qejf dhe sa herë e sa herë e kam kërkuar me pas një mbështetje, tash me tridhjetë e tetë nxënës morëm pjesë në garë shtetërore, Komuna përveç udhëtimit që na ka mbështetë nga Drejtoria e Arsimit, Kryetar mos ta kemi asnjë cent në xhep për të gjithë atë nxënës prej orës 6:30 që jemi nisë e deri në 19:30 në mbrëmje që kemi ardhë në shtëpi dhe mos me pas mundësi një gotë ujë me ia pagu fëmijëve, unë kisha pas qef me pas një derë të hapur. Një herë iu kam drejtuar Nënkrjetarit dhe na ka mbështetë me 200 €, garuesit kësaj here na kanë pyet a keni me na mbështetë prapë me një shujtë ushqimore, thashë jo edhe një numër kurrë më të madh s'kemi pas. Domethënë, kemi qenë komunë shumë e suksesshme në gara. Kisha pas dëshirë me pas një derë të çelur kur i kemi këto udhëtime, kur i kemi këto përfaqësime të qytetit tonë me pas një mbështetje. Por po ju lutem, ta bëjmë një projekt, të punohet në aktivitete fizike, se me të vërtetë zemra po më dhemb, jena shumë keq.

Xhyljeta Imeri: Për Drejtorinë e Arsimit janë ndarë 50.000 € subvencione, 30.000 € kanë qenë për bursat në Shkollën "Arkitekt Sinani", 20.000 € i ka në dispozicion Drejtoria e Arsimit. Besoj që Drejtoria duhet me na mbështetë të gjitha shkollat ku ka nevojë.

Hamdi Hasani: Është e vërtetë që për çështje të shëndetësisë çka të flitet këtu është pak se nuk mjafton, mua veç diçka po më intereson ju si parti i keni një tre-katër deputetë të Mitrovicës, e keni qeverinë atje, a jeni kaq të zëshëm në raport me ta që me marrë para pak më shumë diçka, se nëse është në pyetje 20.000 €, ajo është shumë pak. Po më intereson a jeni kaq të zëshëm me deputetët tuaj atje që për me dhanë ata ndonjë fond a donacion, ndonjë far subvencioni komunës tonë për barna për shëndetësi sepse mundësitë tona, buxheti jonë prej 20.00 € për shëndetësi është hajgare, besoj që atje kishit mujt me marrë më shumë diçka, në qoftë se kanë vullnet me ju ndegju.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara të vitit 2024 dhe viteve paraprake në vitin 2025.

Rezultati i votimit: 22 për, 1 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara të vitit 2024 dhe viteve paraprake në vitin 2025.

Pika 7

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Kryetarit të Komunës z. Bedri Hamza.

Kryetari Bedri Hamza: Të nderuar anëtarë të Asamblesë, para juve e keni Planin e punës për vitin 2025, e kemi diskutuar në Komitet për Politikë dhe Financa, e kom pranua një kritikë me vend prej z. Muzliukaj, që ka thënë se është dashur të vije për diskutim më herët edhe jam pajtuar, se domethënë jemi në fund të muajit prill, ka mund me ardhë të paktën në shkurt, sidoqoftë, është ky plan. Pres pasi që është vit zgjedhor, me u ekzekutua buxheti ashtu qysh është planifikua, në masën më të madhe të mundshme, edhe te pjesa e të hyrave, edhe te pjesa e shpenzimeve, edhe te ekzekutimi i projekteve edhe po du me pas konsideratë për kohën, pasi që materialet i keni marrë në kohë, nuk do ta zgjati më shumë.

Kryesuesja Vesa Broja: Pasi që po flasim për rëndësinë e planit të punës, ne si Kuvend e kemi formu një komision, i cili ka me punu Planin e punës së Kuvendit, për të cilën u thirrë mbledhja që dy herë deri tash edhe për shkak të kuorumit nuk u mbajt asnjë mbledhje, kjo është veç informatë. Po hapim për diskutim, Planin e punës së Kryetarit.

Xhyljeta Imeri: Edhe pse në parim është plani i Kryetarit, në realitet secila drejtori planifikon prioritetet e tyre, fatkeqësisht drejtoresha e Arsimit nuk është këtu që kish mujt me na dhënë ndonjë përgjigje. Është thellësisht shqetësuese dhe e papranueshme që Drejtoria e Arsimit ka zgjedhur të injorojë një projekt të nevojshëm për komunitetin tonë, ndërtimin e aneksit të klasës në Shkollën "Aziz Sylejmani" në Suhodoll, ky projekt, si rezultat i kërkesës sime dhe rëndësisë që ka ishte i planifikuar për vitin 2024 dhe është lënë jashtë për shkak të urdhrave përmbarimorë. Të flasim hapur,

ajo që quhet hapësirë mësimore në atë shkollë, për momentin, nuk është asgjë më shumë se një improvizim i mjerueshëm, është realitet i hidhur. Ndërkohë, që numri i nxënësve në këtë shkollë po rritet falë kontributit të organizatës "Save the children", të cilët me hapjen e Qendrës për kujdes në fëmijëri të hershme e ka shpëtuar nga mbyllja, sepse komuniteti atje ka qenë gjithmonë i prirë t'i dërgojë fëmijët në shkollat e qytetit, e tani ka ndërruar gjendja, prindërit janë familjarizuar me këtë shkollë. Gjithashtu, dua të rikujtoj se kërkesat për vende pune për psikologë dhe asistentë, për fëmijët me nevoja të veçanta nuk janë opsionale, ato janë urgjente. Këto janë kërkesa që kam ngritur vazhdimisht dhe injorimi i tyre është i barabartë me mohimin e të drejtave themelore të fëmijëve që më së shumti kanë nevojë për mbështetje, por fatmirësisht ishin të planifikuar në planin e juaj, uroj dhe pres që deri në muajin shtator këto pozita të jenë funksionale si dhe Çerdhja në Shipol. Një çështje tjetër, që nuk duhet anashkaluar, janë trajnimet për mësimdhënës, të cilat uroj të realizohen sa më shpejt e jo të mbeten në letër, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre në ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve të cilët ndikojnë direkt në cilësinë e arsimit.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025.

Rezultati i votimit: 16 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Miratohet Plan i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025.

Kryesuesja Vesa Broja: Për shkak të mos pjesëmarrjes në votim, kësaj po na kushtëzohet kuorumi i vazhdimit të seancës dhe mbyllim seancën me kaq. Shihemi në seancën e ardhshme.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 14:29 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Afërdita MAXHUNI

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA